



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 qershor 2025
Nr. ref.: AGJ 2719/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO124/25

Parashtrues

Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit
të Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së

“Vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprake dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar "transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025”

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Time Kadrijaj, Bekë Berisha, Ramush Haradinaj, Daut Haradinaj, Lahi Brahimaj, deputetë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme: AAK), Paris Guri, Serbeze Kabashi Muçaj, Arjeta Abazi, Hykmete Bajrami, Jehona Lushaku, deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK) dhe Ferat Shala, deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të cilët i përfaqëson deputetja Time Kadrijaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e *“Vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprahe dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar "transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025”*.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që *“Vendimi [i] Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprahe dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar "transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025”* është në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 63 [Parimet e Përgjithshme], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], 70 [Mandati i Deputetëve], 72 [Papajtueshmëria], dhe 74 [Ushtrimi i Funkcionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme për aktin e kontestuar, duke pezulluar për pasojë *“dëmtimin e pariparueshëm të imazhit të Kuvendit të Kosovës në rast të vazhdimit të seancave konstituive me rend të ditës të përcaktuar në mënyrë jokushtetuese dhe dëmtimin e imazhit të Shtetit të Kosovës në vend dhe në botën e jashtme në rast të vazhdimit të seancave jokushtetuese si më sipër”*.

Baza juridike

5. Kërkesa është parashtruar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 maj 2025, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
7. Në të njëjtën ditë, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO124/25], Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO124/24] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Bajram Ljatifi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 13 maj 2025, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata, për regjistrimin e kërkesës, njoftoi: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryeministrin në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); dhe (iii) Institucionin e

Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit). Gjykata i njoftoi palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, deri më 19 maj 2025.

9. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Zv. Sekretari i Përgjithshëm) për regjistrimin e kërkesës, të cilit iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e çështjes së kontestuar, më së largu deri më 19 maj 2025.
10. Më 15 maj 2025, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin në vijim:
 - (i) Ftesën e Kryetarit të Kuvendit të Legjislaturës VIII për mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike më 8 prill 2025;
 - (ii) Transkriptin nga mbledhja e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike të 8 prillit 2025;
 - (iii) Ftesën e Kryetarit të Kuvendit të Legjislaturës VIII për Seancën Konstituive të Legjislaturës IX më 15 prill 2025;
 - (iv) Vendimin e Kuvendit për formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, nr.09-V-001, të 15 prillit 2025;
 - (v) Raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, të 15 prillit 2025;
 - (vi) Shkresën e Kryesuesit të Seancës Konstituive të Legjislaturës IX, drejtuar Presidentes së Republikës së Kosovës, të 16 prillit 2025;
 - (vii) Përgjigjen e Presidentes së Republikës së Kosovës, të 16 prillit 2025;
 - (viii) Ftesën e Kryesuesit të Seancës Konstituive të Legjislaturës IX, për vazhdimin e Seancës Konstituive, të 17 prillit;
 - (ix) Vendimin e Kuvendit për autorizimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të mandateve, nr.09-V-002, të 19 prillit 2025;
 - (x) Raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, të 19 prillit 2025;
 - (xi) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit, nr. 09-V-003, të 19 prillit 2025;
 - (xii) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit, nr. 09-V-004, të 19 prillit 2025;
 - (xiii) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit, nr. 09-V-005, të 23 prillit 2025;
 - (xiv) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit, nr. 09-V-006, të 25 prillit 2025;
 - (xv) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit, nr. 09-V-007, të 27 prillit 2025;
 - (xvi) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit, nr. 09-V-008, të 29 prillit 2025;
 - (xvii) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 15 prill 2025, e vazhduar më 17,19,21,23,25,27,29 prill 2025 dhe 1,3,5,7,9,11 dhe 13 maj 2025.
11. Më 19 maj 2025, parashtruesit e kërkesës dorëzuan sqarime shtesë lidhur me rastin KO124/25.
12. Në të njëjtën ditë, deputetja Saranda Bogujevci nga Lëvizja Vetëvendosje! dhe deputeti Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës dorëzuan komente lidhur me rastin KO124/25.

13. Më 21 maj 2025, sqarimet shitesë të parashtruesve të kërkesës iu komunikuan Presidentes, Kryeministrit, Avokatit të Popullit dhe Zv. Sekretarit të Përgjithshëm. Të njëjtën ditë edhe parashtruesit e kërkesës u njoftuan lidhur me komentet e dorëzuara nga deputetja Saranda Bogujevci nga Lëvizja Vetëvendosje! dhe deputeti Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës.
14. Më 19 qershor, 24 qershor dhe më 26 qershor 2025, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe vendosi: I. Të deklarojë, njëzëri, kërkesën të pranueshme; II. Të konstatojë, njëzëri që: 1. Seanca e konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 15 prill 2025, nuk ka përfunduar dhe si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës e njëjta nuk është zhvilluar në pajtim me përcaktimet dhe kërkesat e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe 2. Deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] në ndërlidhje me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtimi i Funkcionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kreun IV të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Aktgjykim duhet që sa më shpejt dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë të përfundojnë Seancën Konstituive të Kuvendit duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij; III. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masën e përkohshme; IV. T'ua kumtojë këtë Aktgjykim palëve; V. Ta publikojë këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe VI. Të konstatojë që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 16 gusht 2024, Presidentja znj. Vjosa Osmani, nxori Dekretin [nr.119/2024], për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat u caktuan për t'u mbajtur më 9 shkurt 2025.
16. Më 9 shkurt 2025, u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
17. Më 15 mars 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: KQZ) shpalli rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të mbajtura më 9 shkurt 2025.
18. Më 27 mars 2025, KQZ përmes Vendimit [nr. 01/794-2025] certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të mbajtura më 9 shkurt 2025.
19. Më 8 prill 2025, bazuar në paragrafin 1 të nenit 8 (Përgatitja e seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Kuvendit) u mbajt mbledhja e përbashkët e Kryetarit të legjislaturës VIII me kryetarët e subjekteve politike për përgatitjen e Seancës Konstituive të Kuvendit (legjislatura e IX) që përfshinte agjendën me rendin e ditës së seancës, përfshirë edhe caktimin e ulëseve të deputetëve.
20. Më 15 prill 2025, Kuvendi mbajti seancën e parë konstituive, të kryesuar nga deputeti më i vjetër i Kuvendit, z. Avni Dehari, (në tekstin e mëtejshëm: Kryesuesi) i ndihmuar nga deputetja më e re e Kuvendit, znj. Sala Jashari, sipas rendit të ditës të përcaktuar më 8 prill 2025, si në vijim:
 - (i) Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve;
 - (ii) Dhënia e betimit të deputetëve;
 - (iii) Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe
 - (iv) Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit.

21. Seancën e 15 prillit 2025, e hapi Kryesuesi, i cili kërkoi nga partitë politike që secila të propozojë nga një anëtar për Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve (në tekstin e mëtejme: Komisioni i Përkohshëm). Në këtë drejtim, për anëtarë të Komisionit të Përkohshëm, Lëvizja Vetëvendosje! propozoi deputetin Artan Abrashi, PDK propozoi deputetin Përparim Gruda, LDK propozoi deputetin Armend Zemaj, Lista serbe propozoi deputetin Branislav Nikolić, AAK, Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelktualët propozuan deputeten Time Kadrijaj, Kosova Demokratik Turk Partisi propozoi deputetin Fidan Brina Jiltay, ndërsa për subjektet politike që përfaqësohen me nga një deputet, Kryesuesi lexoi emrat si në vijim: për Iniciativën e Re Demokratike të Kosovës, deputeti Elbert Krasniqi; për Nova Demokratska Stranka, deputetja Emilija Rexhepi; për Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, deputeti Nenad Rashiq; Koalicija Vakati, deputeti Rasim Demiri; për Partinë Liberale Egjiptiane - PLE, deputeti Veton Berisha; Socijaldemokratska Unija - SDU, deputetja Duda Balje; për Partinë e Ashkalinjve për Integrim, deputeti Artan Asllani; Jedinstvena Goranska Partija, deputeti Adem Hoxha dhe për Partinë Rome e Bashkuar e Kosovës, deputeti Albert Kinolli.
22. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, në Seancën Konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, përmes Vendimit [Nr. 09-V-001] formoi Komisionin e Përkohshëm, me përbërjen e propozuar për shqyrtimin e dokumentacionit përkatës të zgjedhjeve për Kuvendin, të mbajtura më 9 shkurt 2025.
23. Pas formimit të tij, Komisioni i Përkohshëm paraqiti raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve, me të cilin konstatoi se në Legjislaturën IX të Kuvendit janë certifikuar 120 deputetë nga partitë politike, koalicionet dhe iniciativat qytetare, si në vijim:
 - (i) Lëvizja Vetëvendosje! – 48 deputetë;
 - (ii) Partia Demokratike e Kosovës – 24 deputetë;
 - (iii) Lidhja Demokratike e Kosovës – 20 deputetë;
 - (iv) Lista serbe – 9 deputetë;
 - (v) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelktualët – 8 deputetë;
 - (vi) Kosova Demokratik Turk Partisi – 2 deputetë;
 - (vii) Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – 1 deputet;
 - (viii) Nova Demokratska Stranka – 1 deputet;
 - (ix) Za Slobodu, Pravdu i Opstanak – 1 deputet;
 - (x) Koalicija Vakati – 1 deputet;
 - (xi) Partia Liberale Egjiptiane – 1 deputet;
 - (xii) Partia e Ashkalinjve për Integrim – 1 deputet;
 - (xiii) Socijaldemokratska Unija – 1 deputet;
 - (xiv) Jedinstvena Goranska Partija – 1 deputet;
 - (xv) Partia Rome e Bashkuar e Kosovës – 1 deputet.
24. Kryesuesi, pasi konstatoi se në sallë ishin 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) deputetë, kërkoi nga të njëjtët të deklarohen për raportin e Komisionit të përkohshëm, i cili pas votimit konstatoi se nuk kaloi, për shkak se 52 (pesëdhjetë e dy) deputetë votuan për, 46 (dyzet e gjashtë) kundër dhe 11 (njëmbëdhjetë) abstenuan.
25. Më 16 prill 2025, Kryesuesi e njoftoi Presidenten se Raporti i Komisionit të Përkohshëm nuk kishte marrë votat e shumicës së deputetëve dhe se për këtë arsye mandatet e deputetëve nuk u verifikuan, nuk u procedua me betimin e deputetëve të Kuvendit, si dhe Kryesuesi ndërpreu seancën konstituive.

26. Në të njëjtën ditë, Presidentja ju përgjigj letrës së Kryesuesit, në të cilën rikujtoi parimet kushtetuese, të përcaktuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe obligimin e Kryesuesit dhe të të gjithë deputetëve të zgjedhur në Legjislaturën e IX të Kuvendit për funksionalizimin e institucioneve. Po ashtu, rikujtoi obligimin për vazhdimin e seancës konstituive jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga ndërprerja e saj.
27. Në të njëjtën ditë, Kryesuesi përmes shkresës [L-IX SK – 001/1] ftoi të gjithë deputetët e Kuvendit të marrin pjesë më 17 prill 2025 në vazhdimin e punimeve të seancës konstituive të filluar më 15 prill 2025.
28. Më 17 prill 2025, vazhdoi Seanca Konstituive, ku të pranishëm ishin 100 deputetë. Kryesuesi ndërpreu seancën për ta vazhduar brenda 48 orëve për shkak se në takimin konsultues nuk pati konsensus.
29. Më 19 prill 2025, vazhdoi Seanca Konstituive, ku të pranishëm ishin 120 deputetë. Kryesuesi vendosi në votim formimin e Komisionit të Përkohshëm me përbërje të njëjtë, propozim që u votua nga 120 deputetë dhe nga Komisioni i Përkohshëm u kërkuar që të përpilojë raportin e ri. Komisioni i Përkohshëm paraqiti raportin, me të cilin konstatoi vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe i njëjti kaloi në mënyrë unanime. Gjithashtu, në kuadër të kësaj seance, të gjithë deputetët dhanë betimin e tyre.
30. Po të njëjtën ditë, Kryesuesi, vazhdoi me rendin e ditës dhe kërkoi nga Lëvizja Vetëvendosje! ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit, ku kjo e fundit propozoi deputeten Albulena Haxhiu. Propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje! nuk kaloi për shkak se i mori 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për, 20 (njëzet) kundër, dhe 3 (tre) abstenime. Pas votimit seanca u ndërpre për 15 minuta. Pas vazhimit të seancës, Kryesuesi vazhdoi me rendin e ditës dhe kërkoi nga Lëvizja Vetëvendosje! ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit, ku kjo e fundit propozoi deputeten Albulena Haxhiu. Propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje! nuk kaloi për shkak se mori 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për, 19 (nëntëmbëdhjetë) kundër dhe 3 (tre) abstenime. Pas votimit seanca u ndërpre.
31. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes Vendimit [Nr. 09-V-003] nuk zgjodhi deputeten Albulena Haxhiu Kryetare të Kuvendit.
32. Më pas, Seanca Konstituive vazhdoi më 21, 23, 25, 27 dhe 29 prill 2025, në të cilat seanca propozimi për Kryetare të Kuvendit ishte i njëjtë dhe për të cilin deputetët votuan si në vijim:
 - (i) Në seancën e 21 prillit 2025, ku të pranishëm ishin 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) deputetë, propozimi nuk doli në votim, për shkak se Lëvizja Vetëvendosje! kërkoi kohë shtesë;
 - (ii) Në seancën e 23 prillit 2025, ku të pranishëm ishin 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) deputetë, 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për; 46 (dyzet e gjashtë) kundër dhe 3 (tre) abstenime;
 - (iii) Në seancën e 25 prillit 2025, ku të pranishëm ishin 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) deputetë, 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për; 47 (dyzet e shtatë) kundër dhe 3 (tre) abstenime;
 - (iv) Në seancën e 27 prillit 2025, ku të pranishëm ishin 109 (njëqind e nëntë) deputetë, 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për; 41 (dyzet e një) kundër dhe 3 (tre) abstenime; dhe
 - (v) Në seancën e 29 prillit 2025, ku të pranishëm ishin 110 (njëqind e dhjetë) deputetë, 54 (pesëdhjetë e katër) vota për, 44 (dyzet e katër) kundër dhe 3 (tre) abstenime.

33. Kuvendi, përmes vendimeve [Nr. 09-V-004; të 19 prillit 2025; Nr. 09-V-005; të 23 prillit 2025; Nr. 09-V-006; të 25 prillit 2025; Nr. 09-V-007; të 27 prillit 2025; dhe Nr. 09-V-008, të 29 prillit 2025] nuk zgjodhi deputeten Albulena Haxhiu Kryetare të Kuvendit.
34. Më 1 maj 2025, në vazhdimin e Seancës Konstituive, nga procesverbali i mbledhjes rezultoi që Kryesuesi konstatoi se të pranishëm ishin 110 (njëqind e dhjetë) deputetë dhe theksoi që *“Deri sot kemi pasur disa tentime, por pa prodhuar rezultate në zgjedhjen e kryesisë dhe konstituimit të Kuvendit. Duke marrë parasysh aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014 për çështjen e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, përkatësisht paragrafin 124 ku thuhet: “Votimi mund të jetë i formës së hapur, i fshehtë apo çfarëdo forme tjetër.” si dhe, bazuar edhe në Rregulloren e Kuvendit, e cila në nenin 61, paragrafi 4 e parasheh edhe votimin e fshehtë. Andaj me qëllim të hapjes rrugë për zhbllokimin e procesit, konsideroj që forma e duhur që mund të hapë rrugë për konstituimin është votimi në mënyrë të fshehtë me fletëvotime fizike.”* Në vijim të kësaj, Kryesuesi ftoi partitë politike që të propozojnë nga 1 (një) anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë, lidhur me ndryshimin e mënyrës së votimit. Si rrjedhojë, nga shkresat e lëndës rezultoi që Kryesuesi ftoi deputetët që të votojnë anëtarët e komisionit të propozuar, për të cilin 55 (pesëdhjetë e pesë) deputetë votuan për, 1 (një) deputet kundër dhe asnjë abstenim.
35. Seanca Konstituive vazhdoi më 3 maj 2025, me ç’rast, pasi që Kryesuesi konstatoi se në sallë ishin 106 (njëqind e gjashtë) deputetë, kërkoi përsëri nga partitë politike të propozojnë anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë, të cilin e vendosi në votim, mirëpo ky propozim mori 54 (pesëdhjetë e katër) vota për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim. Kryesuesi ndërpreu seancën duke konstatuar që nuk ka kuorum si dhe njoftoi të pranishmit për vazhdimin e seancës më 5 maj 2025.
36. Seanca Konstituive vazhdoi më 5 maj 2025, me ç’rast, pasi që Kryesuesi konstatoi që në sallë janë 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë, kërkoi përsëri nga partitë politike të propozojnë anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë, të cilin e vendosi në votim, mirëpo ky propozim mori 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprake dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar “transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025” janë nxjerrë në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 63 [Parimet e Përgjithshme], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkrjetarëve], 70 [Mandati i Deputetëve], 72 [Papajtueshmëria], dhe 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës.*
38. Parashtruesit e kërkesës, përkritazi me shkeljen e neneve 70 dhe 72 të Kushtetutës pretendojnë se në listën e 120 (njëqind e njëzet) deputetëve të verifikuar si të vlefshëm me mandatet e tyre hyjnë edhe disa që njëkohësisht ushtrojnë funksione ekzekutive.
39. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ndryshim i rendit të ditës së seancës konstituive nga Kryesuesi është në kundërshtim me Kushtetutën dhe se në mënyrë arbitrare Kryesuesi pas çdo dështimi të marrjes së votave të mjaftueshme, ka urdhëruar ndërprerjen e seancës.

40. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“I njëjti këtë e ka bërë edhe kur ka ndodhur dështimi për kalimin në votimin e fshehtë, duke devijuar dhe pamundësuar votimin e deputetëve për kryetar të Kuvendit ashtu siç përcaktohet me rendin e ditës së datës 8 prill 2025, që është rruga e vetme kushtetuese e përcaktuar me RPK dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014 për rastin KO 119/14.”*
41. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se: *“[...] çdo rast i votimit në Kuvendin e Kosovës, pa marrë parasysh formën formale të materializimit të shprehjes së këtij votimi, përbën vendim nëse plotësohen kushtet e caktuara, [...]”.*
42. Më tej, parashtruesit e kërkesës duke cituar paragrafin 3 të nenit 11 (Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit, theksojnë se: *“[...] as për zgjedhjen e as për moszgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të Kosovës nuk ekziston një formë e përcaktuar me shkrim në RP dhe, për rrjedhojë, sipas analogjisë, duhet të zbatohen rregullat e njëjta për dy rastet e votimit për kryetar të Kuvendit, përkatësisht si kur bëhet zgjedhja ashtu edhe kur refuzohet zgjedhja e kryetarit të Kuvendit.”*
43. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se akt i kontestuar me këtë parashtrësë emërtohet Procesverbali i Seancës Konstituive, i 5 majit 2025 të Kuvendit duke theksuar se: *“hyn në fushëveprimin e "vendimit të Kuvendit", siç përcaktohet me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, për arsye se: (i) është miratuar me shumicë votash të deputetëve të Kuvendit; (ii) përfshin udhëzime specifike dhe obligime, të cilat janë të detyruara t' i zbatojnë deputetët, përkatësisht të mblidhen çdo në seancën e radhës për të njëjtën çështje; (iii) pas nxjerrjes së Aktit të kontestuar, deputetët kanë ndërmarrë veprime për zbatimin e zbatimit të tij, ndër të tjera, duke provuar arritjen e një marrëveshjeje politike për zhbllokim të gjendjes (deputetët e Kuvendit kanë bërë të qartë se nuk votojnë në mënyrë fshehtë por do të votonin hapur një kandidat tjetër përveç zonjës Albulena Haxhiu) dhe (iv) për pasojë, gjendja aktuale ndikon në cenimin e normave kushtetuese, përfshirë kufizimin e të drejtave dhe lirive të deputetëve për të ushtruar detyrën e tyre të përcaktuar me Kushtetutë.”*
44. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“[...] Në aspektin përmbajtësor, në kuptim të praktikës së Gjykatës Kushtetuese të përshkruar si më sipër, sjelljet e ztr. Avni Dehari që kanë prodhuar Aktin e kontestuar objekt i kësaj kërkesë nuk janë njëkohësisht në pajtueshmëri me nenin 4.1 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 63 [Parimet e Përgjithshme], nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], nenin 70.1 [Mandati i Deputetëve], nenin 72 [Pajtueshmëria], si dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta").”*
45. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se akti i kontestuar *“i përmbajtur në Procesverbalin e Seancës Konstituive”*, si dhe të gjitha veprimet të natyrës së njëjtë në seancat *“paraprake dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje është në pajtueshmëri me paragrafin 14 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës”*; (iii) të konstatojë se akti i kontestuar *“i përmbajtur në Procesverbalin e Seancës Konstituive”*, si dhe të gjitha veprimet të natyrës së njëjtë në seancat *“paraprake dhe të mëpastajme”* për të njëjtën çështje nuk janë në pajtueshmëri me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 63 [Parimet e Përgjithshme], nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve], nenin 72 [Pajtueshmëria], si dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës të dorëzuara përmes parashtresës së 19 majit 2025

46. Më 19 maj 2025, parashtruesit e kërkesës parashtruan komente shtesë me qëllim të sqarimit të mëtejshëm të kërkesës.
47. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se kërkesa në rastin KO124/25 ka për objekt interpretimin e Kushtetutës në lidhje me: (i) *“necjet dramatike aktuale në procedurën e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, si pasojë e devijimit të rendit të ditës të përcaktuar më 8 prill 2025 [...]”*; dhe (ii) *“abuzimin me dispozitën kushtetuese të nenit 67.2 të Kushtetutës, që i jep të drejtën fituesit relativ të zgjedhjeve për të propozuar kandidatin e njëjtë për kryetar të Kuvendit.”*
48. Më tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se kontestojnë kushtetutshmërinë e *“vendimit për refuzimin e votimit të fshehtë, si dhe vendimet e tjera që lidhen me kandidimin e pandërprerë të zonjës Albulena Haxhiu për kryetare të Kuvendit.”*
49. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se objekt i kërkesës është edhe *“votimi si akt për refuzimin e votimit të fshehtë në procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht akti i votimit që refuzon këtë lloj votimi.”* Ndërsa theksojnë se objekt i kërkesës nuk është *“vendimi individual dhe arbitrar i zotit Avni Dehari për ndryshimin e agjendës së datës 8 prill 2025 për konstituimin e Kuvendit, por pasojat juridike dhe kushtetuese të këtij vendimi”* dhe se *“Vendimi i kryesuesit të Kuvendit, ashtu si edhe ai i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, nuk mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues”*.
50. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se *“në nivel evropian, asnjë akt, veprim apo mosveprim i autoriteteve publike nuk guxon të qëndrojë jashtë kontrollit kushtetues, siç dëshmohet nga opinionet e Komisionit të Venecias.”* (shih, Opinionin CDL – AD(2016)007).
51. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se *“çdo akt (veprim ose mosveprim) i Kuvendit gjatë ushtrimit të juridiksionit të tij kushtetues duhet të jetë objekt i kontrollit kushtetues me kusht që: (i) të ketë pasur votim për të; (ii) akti (veprimi ose mosveprimi) të ngrejë çështje kushtetuese dhe, së fundi, (iii) të jetë ndërmarrë në kohën kur ka pasur kuorum në Kuvend.”*
52. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se: *“[...] në të gjitha rastet kur ka ndodhur ndryshimi i rendit të ditës është kryer votim dhe ka pasur kuorum në Kuvend”*. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se moskonstituimi i Kuvendit përbën çështje fundamentale kushtetuese, për arsye se ndikon në funksionimin e organeve kushtetuese.
53. Në fund, parashtruesit e kërkesës propozojnë që: *“(i) të shpallet kërkesa e pranueshme për shqyrtim dhe vendimmarrje në themel; (ii) të anulohen si jokushtetuese të gjitha vendimet e Kuvendit të Kosovës për ndryshimin e rendit të ditës të datës 8 prill 2025; (iii) të rikthehet situata kushtetuese e datës 8 prill 2025 dhe të urdhërohet veprimi në përputhje me udhëzimet e Aktgjykimit KO119/14 lidhur me procedurën kushtetuese që duhet ndjekur për konstituimin e Kuvendit të Kosovës pas çdo zgjedhjeje të përgjithshme; (iv) të kufizohet mundësia e propozimit të të njëjtit kandidat për Kryetar të Kuvendit të Kosovës më shumë se një herë; (v) të përcaktohet një afat kohor brenda të cilit Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet pas mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme.”*

Komentet e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje!

54. Më 19 maj 2025, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje!, të përfaqësuar nga deputetja Saranda Bogujevci dorëzuan në Gjykatë komentet ndaj pretendimeve të parashtresve të kërkesës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së *“[...] vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të komisionit për votim të fshehtë, si dhe për të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë të marra në seancat paraprahe dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje”*.
55. Fillimisht, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksuan arsyet se pse: *“1) votimi i Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në çdo formë, përfshirë atë të fshehtë, është obligim i deputetëve të Republikës së Kosovës në qëllim të konstituimit të Kuvendit dhe fillimit të mandatit të Kuvendit si organ legjislativ si dhe, 2) pse nuk ka konflikt interesi ndërmjet qeverisë në dorëheqje të Republikës së Kosovës në raport me legjislaturën e re të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, do të dëshmohet që vlerësimi i kushtetutshmërisë së votimeve të deputetëve gjatë seancës konstituive, edhe po të ishin vendime, nuk do ishin në shkelje të nenit 4.1, nenit 7, nenit 3, nenit 67, nenit 70.1., 72 dhe 74 të Kushtetutës.”*
56. Më tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje cituan nenin 31 (Kufizimet e Qeverisë në dorëheqje) të Ligjit për Qeverinë dhe theksuan se Qeveria *“Kurti II”* konsiderohet Qeveri në dorëheqje dhe kryen përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen të Ligjit për Qeverinë dhe në harmoni me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO95/20. Gjithashtu, theksuan se pas kalimit të mandatit 4 (katër) vjeçar të legjislaturës së VIII-të të Kuvendit, përfundon edhe mandati i Qeverisë, e cila nuk mund të miratojë më politika të reja në formë ligjesh apo marrëveshjes ndërkombëtare, të cilat kërkojnë aprovim nga Kuvendi.
57. Po ashtu, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! nënvizuan se: *“[...] pas certifikimit të rezultatit zgjedhor, qeveria e cila ushtron detyrën, përfshirë këtu anëtarët e qeverisë pra, nuk mund të vazhdojnë punën në qeveri me mandat të plotë apo kompetenca të plota. Kjo për të përmbushur kërkesën e nenit 70 dhe nenit 72 të Kushtetutës, ashtu që të parandalohet konflikti i interesit dhe ashtu që qeveria me mandat të plotë të kalojë në kompetenca të limituara të qeverisë në dorëheqje.”* Të njëjtit theksuan se: *“[...] në rastin aktual ku qeveria ka humbur mandatin sipas vetë fuqisë së ligjit dhe vepron me kompetenca të limituara deri në formimin e qeverisë së re, nuk krijon asnjë lloj konflikti me legjislaturën e nëntë e cila nuk e ka zgjedhur. Prandaj edhe nuk ka papajtueshmëri në funksione dhe as shkelje të nenit 70 e 72 të Kushtetutës.”*
58. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! përkritazi me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve, si dhe detyrës së deputetit gjatë seancës konstituive, theksuan se deri sa nuk zgjedhën Kryetari i Kuvendit dhe nënkryetarët e tij, nuk ka Kuvend të konstituuar dhe puna e legjislativit nuk mund të fillojë. Në këtë drejtim, theksuan se deputetët e kanë detyrë parësore konstituimin e Kuvendit dhe se është detyrim i çdo deputeti *“të bashkëpunojë aktivisht në procesin e konstituimit të Kuvendit pasi që ky është një hap themelor për funksionimin e institucioneve demokratike.”*
59. Më tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! përkritazi me pretendimin e parashtresve të kërkesës për ndryshimin e mënyrës së votimit në mes të procedurës, theksojnë se i njëjti është krejtësisht i paqëndrueshëm, për shkak se *“Votimi i Kryetares së Kuvendit pas çdo dështimi për ta votuar është thjesht procedurë e re dhe nga fillimi”*.
60. Gjithashtu, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksuan se parashtresë i kërkesës në mënyrë të pasaktë ka paraqitur titullin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së *“vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të*

fshehtë”, për shkak se: “jo vetëm që nuk bëhet fjalë për vendim të Kuvendit as në formë e as të mishëruar në procesverbal siç pretendojnë parashtruesit, por nuk bëhet fjalë as për kushtet e nevojshme për vendimmarrje për refuzim të votimit të Komisionit, për bëhet fjalë për mungesë kuorumi për të marrë vendim qoftë edhe për vendim për ta refuzuar votimin e Komisionit”. Në këtë drejtim, potencuan se nuk ka pasur propozim për ndryshim të rendit të ditës së seancës, gjë që mund të vërehet nga transkripti. Gjithashtu, thekson se nuk është e vërtetë që nuk ka pasur propozime për anëtar të Komisionit, sepse ka më shumë subjekte politike që kanë propozuar anëtarë sesa që nuk kanë propozuar.

61. Më tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! konsiderojnë se nga data 1 maj deri në datën kur Lëvizja Vetëvendosje! ka dorëzuar komentet nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, e kësaj nuk ka pasur asnjë vendim të Kuvendit, as për refuzim të Komisionit e as për moszgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit.
62. Në fund, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! përkritazi me pranueshmërinë e kërkesës theksuan se parashtruesit e kërkesës për vazhdimin e seancës konstituive të 5 majit 2025 kanë parashtruar kërkesën brenda afatit, ndërsa për vazhdimet para 1 majit kërkesa është e pasafatshme për arsye se kërkesa është dorëzuar më 12 maj 2025, si dhe në këtë rast nuk kemi akt të miratuar nga Kuvendi të çfarëdo natyre apo forme, të shkruar apo të pashkruar, që do të prodhonte çfarëdo pasoje juridike. Në këtë rrjedhë, konsiderojnë se: *“Në vazhdimin e seancës konstituive të mbajtur më 5 maj kanë marrë pjesë në votim për themelimin e Komisionit vetëm 57 deputetë, nga të cilët 56 deputetë kanë votuar PËR dhe 1 deputet ka votuar kundër, duke bërë që Kryesuesi i seancës të konstatoi se nuk ka kuorum për miratim të vendimit.”*

Komentet e deputetit Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës

63. Më 19 maj 2025, deputeti Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK) dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën në rastin KO124/25.
64. Fillimisht, deputeti sqaroi se konsideron se kërkesa e parashtruar nga deputetët i përmbush cilësitë e palës së autorizuar siç përcaktohet në paragrafin 5 të nenit 115 të Kushtetutës dhe gjithashtu kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 42 të Ligjit dhe se gjithashtu thekson se kërkesa *“ngre çështje të rëndësishme kushtetuese”*.
65. Përkritazi me karakterin e Seancës Konstituive, deputeti i PDK-së në komente e tij citon Aktgjykimin e Gjykatës KO119/14 duke konsideruar se: *“[...] del që kryesuesi i seancës konstituive, e ka për obligim që të realizojë plotësisht seancën konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, [...]”*
66. Më tej, deputeti nga PDK konsideron se *“çdo ndryshim i rendit të ditës së seancës konstituive përtej pikave të përcaktuara është jokushtetues dhe në thelb, si i tillë, është në kundërshtim me rolin dhe funksionin e kryesuesit të seancës konstituive”*.
67. Gjithashtu, thekson se nuk ka pasur mocion procedural për propozimin e ndryshimit të mënyrës së votimit për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, i cili do të mund të propozohej vetëm në fillim të seancës konstituive, ndërkaq thekson se: *“[...] jo vetëm që nuk ka pasur mocion paraprakisht dhe as votim për një mocion të tillë, por edhe vendosja në votim, në mënyrë të vazhdueshme për themelimin e Komisionit për Votim të Fshehtë është jokushtetues veçanërisht për faktin e thjeshtë se i njëjti qartazi nuk ka marrë (dhe nuk po i merr) votat e mjaftueshme nga deputetët e për rrjedhojë, edhe nën supozimin e ekzistencës së kushteve paraprake (mocionit të lartcekur) për shqyrtimin e tij nga Kuvendi, fakti i moskalimit të të njëjtit nënkupton rrëzimin e këtij mocioni –*

propozimi, e për rrjedhojë në vijimin e seancës për shqyrtimin e propozimit për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit me votim të hapur”.

68. Deputeti nga PDK thekson se “Kuvendi ka marrë vendim për mosvotim të këtij komisioni, e për rrjedhojë, ka marrë vendim për refuzim të votimit të fshehtë si njëra ndër mënyrat e votimit në Kuvend. Ndërsa, rivendosja e kësaj pike nga kryesuesi z. Dehari për votim nga Kuvendi në çdo vazhdim të seancës konstituive paraqet shkelje kushtetuese e cila si e tillë natyrisht se në vetvete përbën çështje të natyrës kushtetuese e cila meriton vlerësim nga ana e kësaj gjykate”.
69. Më tutje, përkitazi me mos-propozimin e Kryetarit të Kuvendit, deputeti nga PDK thekson se: “[...] ashtu siç nuk është e përhershme e drejta për të caktuar mandatarin vetëm partia fituese sipas rezultatit të zgjedhjeve, nuk mund të jetë e përhershme as e drejta e partisë së parë/grupit më të madh parlamentar të dalë nga zgjedhjet që të propozojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme Kryetarin e Kuvendit, sepse një e drejtë e tillë për të propozuar Kryetarin e Kuvendit, në pikëpamje kushtetuese nuk mund të shërbej si mekanizëm për të bllokuar konstituimin e Kuvendit [...]”.
70. Në fund, deputeti nga PDK thekson se: “e drejta e propozimit të Kryetarit të Kuvendit nga ana e grupit më të madh parlamentar i dalë pas zgjedhjeve, është relative dhe jo absolute dhe si e tillë sipas pikëpamjes time, duhet të interpretohet vetëm në simetri me procedurën kushtetuese të zgjedhjes së Qeverisë.”

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 1

[Përkufizimi i Shtetit]

1. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.
2. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.
3. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.

Neni 2

[Sovraniteti]

1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në formë të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
3. Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Neni 7 **[Vlerat]**

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.
2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 63 **[Parimet e Përgjithshme]**

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Neni 64 **[Struktura e Kuvendit]**

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon: (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); (2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti

Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Neni 65 **[Kompetencat e Kuvendit]**

Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1)

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*
- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;*
- (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;*
- (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;*
- (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;*
- (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;*
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;*
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;*
- (10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;*
- (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;*
- (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;*
- (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.*

Neni 66 **[Zgjedhja dhe Mandati]**

- 1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.*
- 2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.*
- 3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.*
- 4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për atë sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.*

Neni 74 **[Ushtrimi i Funksionit]**

Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

Neni 134
[Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
[.]

Neni 136
[Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]

- [...]
3. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.

[...]

Neni 140
[Banka Qendrore e Kosovës]

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, është institucion i pavarur i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës.
[...]

Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës

KREU IV
KONSTITUIMI I KUVENDIT

Neni 7
Seanca konstituive

1. Seancën konstituive të Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.
2. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk e thërret seancën konstituive, Kuvendi mbledhet vetë në ditën e tridhjetë (30).

Neni 8
Përgatitja e seancës konstituive

1. Përgatitjet për seancën konstituive të legjislaturës së Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit të legjislaturës së mëparshme.
2. Kryetari i legjislaturës së mëparshme, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit, e thërret mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike, që kanë fituar vende në Kuvend, për të përgatitur propozimin e rendit të ditës dhe për caktimin e vendeve të deputetëve në sallën e seancave plenare. Në rast se mbledhja nuk thirret brenda afatit pesë (5) ditorë, Kuvendi mbledhet vetë, në ditën e caktuar nga Presidenti.
3. Paragrafi 2 i këtij neni, nuk zbatohet në rast se Kuvendi mbledhet sipas nenit 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.
4. Rendi i ditës së mbledhjes konstituive të legjislaturës përmban:

- 4.1. Formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve;
- 4.2. Betimin e deputetëve;
- 4.3. Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe
- 4.4. Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit.
5. Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve votohet nga Kuvendi.
6. Përcaktimi i vendeve të deputetëve në sallë bëhet sipas fuqisë të subjekteve politike. Nëse dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, renditja e tyre bëhet duke marrë për bazë numrin më të madh të votave që kanë fituar në zgjedhjet për Kuvend.

Neni 9 **Kryesimi i seancës konstituive**

1. Punimet e seancës konstituive, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, i drejton deputeti më i vjetër në moshë, i ndihmuar nga deputeti më i ri në moshë.
2. Nëse deputeti ose deputetët nga paragrafi 1 i këtij neni, mungojnë në seancën konstitutive ose refuzojnë drejtimin e seancës, angazhohen deputetët tjerë sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në seancën konstituive nuk zhvillohet debat.
4. Kryesuesi i seancës konstituive, pas hapjes së seancës dhe pas paraqitjes së rendit të ditës, kërkon nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, të caktojnë nga një deputet në Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve. Komisionin e kryeson deputeti i subjektit politik më të madh parlamentar.
5. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, i paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit, verifikon praninë dhe kuorumin në seancën konstituive.

Neni 10 **Betimi i deputetëve**

1. Pas verifikimit të mandateve, kryesuesi i seancës konstitutive i fton deputetët të betohen solemnisht. Teksti i deklaratës së betimit është:

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë shtetasve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e sovranitetit, tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit. Betohem!”

2. Deklaratën e betimit e lexon kryesuesi i seancës. Deputetët betohen duke shqiptuar në fund të deklaratës, fjalën “Betohem!”. Secili deputet e nënshkruan deklaratën e betimit.

3. Deputeti që mungon në seancën konstituive të legjislaturës kur bëhet betimi dhe deputeti që fiton mandatin gjatë legjislaturës, betimin e bëjnë në seancën e parë të rregullt të radhës.

4. Deputeti i cili nuk e bën betimin në seancën e parë të rregullt të radhës, siç përcaktohet me paragrafin 3 të këtij neni, nëse ka pamundësi objektive për ta bërë

atë brenda këtij afati, e dërgon njoftimin me shkrim te Kryetari i Kuvendit, lidhur me shkaqet që justifikojnë mungesën e tij dhe betimin e bën pas kalimit të rrethanave të tilla, por jo më vonë se në seancën e tretë të rregullt të radhës, pas fitimit të mandatit si në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 11 **Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit**

- 1. Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstituive, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 2. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga subjekti politik më i madh në Kuvend, të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit.*
- 3. Kryesuesi i seancës konstituive konstaton rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, shpall zgjedhjen e Kryetarit dhe e fton të zërë vendin e tij.*

Neni 12 **Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit**

- 1. Nënkryetarët e Kuvendit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 2. Kryetari i Kuvendit kërkon nga tri subjektet politike më të mëdha parlamentare të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër, nga ai i Kryetarit.*
- 3. Në rast se dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, e drejta e propozimit të nënkryetarit i takon subjektit që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet për Kuvend.*
- 4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 5. Seanca konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.*
- 6. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:*
 - 6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe*
 - 6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.*
- 7. Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit.*

Neni 13 **Mandati i Kuvendit**

- 1. Mandati i Kuvendit, vazhdimi i tij dhe shpërndarja e Kuvendit, janë përcaktuar me nenet 66 dhe 82 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.*
- 2. Pas shpërndarjes së Kuvendit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Presidenti e dorëzon dekretin e shpërndarjes në Kuvend.*
- 3. Kuvendi e pezullon punën një ditë para fillimit të fushatës për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin.*

Dispozitat relevante kushtetuese të vendeve tjera

Gjermania (Ligji themelor)

Neni 39 [Mandati zgjedhor – Thirrja]

1. Përveç dispozitave në vijim, Bundestagu zgjidhet për një periudhë katërvjeçare. Mandati i tij përfundon kur mbledhet Bundestagu i ri. Zgjedhjet e reja mbahen jo më herët se pas dyzet e gjashtë muajve dhe jo më vonë se pas dyzet e tetë muajve nga fillimi i mandatit elektoral. Nëse Bundestagu shpërndahet, zgjedhjet e reja mbahen brenda gjashtëdhjetë ditëve.
2. Bundestagu mbledhet jo më vonë se dita e tridhjetë pas zgjedhjeve.
3. Bundestagu vendos kur seancat e tij shtyhen dhe rifillojnë. Kryetari i Bundestagut mund ta thërrasë atë në një datë më të hershme. Ai është i detyruar ta bëjë këtë nëse një e treta e Deputetëve, Presidenti Federal ose Kancelari Federal e kërkojnë atë.

Neni 40. [Presidenca – Rregullorja e punës]

1. Bundestagu zgjedh Kryetarin, Nënkryetarët dhe sekretarët e tij. Ai miraton Rregulloren e punës.
2. Kryetari ushtron kompetencat pronësore dhe policore në ndërtesën e Bundestagut. Asnjë kontroll apo sekuestrim nuk mund të kryhet në hapësirat e Bundestagut pa lejen e tij.

Rregullorja e punës

Rregulli 1 Mbledhja konstituive

- (1) Mbledhja e parë e Bundestagut të sapozgjedhur thirret nga Kryetari në largim dhe mbahet jo më vonë se në ditën e tridhjetë pas zgjedhjeve (Neni 39 i Ligjit themelor).
- (2) Derisa Presidenti i sapozgjedhur ose njëri nga Nënkryetarët të marrë detyrën, Deputeti i Bundestagut që ka shërbyer më së gjati që e shpreh vullnetin e kryeson mbledhjen (Kryesuesi sipas vjetërsisë); kur dy ose më shumë deputetë kanë të njëjtën periudhë të shërbimit, vendimtare do të jetë moshë më e madhe.
- (3) Kryesuesi sipas vjetërsisë emëron përkohësisht deputetë të Bundestagut si Sekretarë. Më pas thirret lista me emrat e deputetëve të Bundestagut.
- (4) Pasi të jetë konstatuar prania e kuorumit, zgjidhen Kryetari, Nënkryetarët dhe Sekretarët.

Rregulli 2 Zgjedhja e Kryetarit dhe e Nënkryetarëve

- (1) Bundestagu, me votim të fshehtë dhe të veçantë (Rregulli 49), zgjedh Kryetarin dhe Nënkryetarët për kohëzgjatjen e mandatit elektoral. Çdo grup parlamentar në Bundestagun gjerman përfaqësohet në Presidium me së paku një Nënkryetar.
- (2) Zgjidhet kandidati që merr shumicën e votave të deputetëve të Bundestagut. Nëse shumica nuk arrihet në votimin e parë, mund të propozohen kandidatë të rinj për votimin e dytë. Nëse as pas votimit të dytë nuk sigurohet shumica e votave të deputetëve të Bundestagut, mbahet votimi i tretë. Nëse në votimin e tretë ka vetëm një kandidat, ky kandidat zgjidhet nëse merr shumicën e votave të hedhura. Në

rast se ka disa kandidatë, dy kandidatët me numrin më të madh të votave kalojnë në votimin e tretë; zgjidhet kandidati që merr më së shumti vota. Në rast barazimi, Kryesuesi që e kryeson mbledhjen hedh short për të përcaktuar se cili nga dy kandidatët zgjidhet.

Italia (Kushtetuta)

Neni 61

Zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen brenda shtatëdhjetë ditëve nga përfundimi i mandatit të Dhomave të mëparshme. Mbledhja e parë thirret jo më vonë se njëzet ditë pas zgjedhjeve.

Derisa të mblidhen Dhomat e reja, kompetencat e Dhomave të mëparshme vazhdojnë.

Spanja (Kushtetuta)

Neni 68

[...].

1. Zgjedhjet zhvillohen ndërmjet tridhjetë dhe gjashtëdhjetë ditëve pas përfundimit të mandatit të mëparshëm. Kongresi i zgjedhur duhet të mblidhet brenda njëzet e pesë ditëve pas mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 72

[...]

2. Dhomat zgjedhin Kryetarët përkatës dhe anëtarët e tjerë të byrove të tyre. Seancat e përbashkëta kryesohen nga Kryetari i Kongresit dhe qeverisen nga Rregullorja e punës së “Cortes Generales”, e miratuar nga shumica e përgjithshme e anëtarëve të secilës Dhomë.

[...]

Suedia (Instrumenti i Qeverisjes)

Kreu 8.

Organet dhe zyrtarët e caktuar

Neni 1

Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit të Parë, të Dytë dhe të Tretë sipas Kreut 4, Nenit 2 të Instrumentit të Qeverisjes mbahet në mbledhjen e parë të Dhomës në periudhën zgjedhore të Riksdagut dhe është e vlefshme deri në fund të periudhës zgjedhore. Kryetarët zgjidhen veçmas, në rendin e mësipërm.

Nëse zgjedhja bëhet me votim të fshehtë, zgjidhet kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të hedhura. Nëse nuk arrihet një shumicë e tillë, zhvillohet një zgjedhje e re. Nëse as në këtë rast asnjë kandidat nuk merr më shumë se gjysmën e votave të hedhura, zhvillohet një zgjedhje e tretë ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të lartë të votave në zgjedhjen e dytë. Personi që merr numrin më të madh të votave në zgjedhjen e tretë zgjidhet.

Polonia (Kushtetuta)

Neni 109

1. [...]

2. Mbledhja e parë e Sejmit dhe Senatit thirret nga Presidenti i Republikës që të mbahet në një ditë brenda tridhjetë ditëve pas ditës së zgjedhjeve, përveç rasteve të parashikuara në nenin 98, paragrafët 3 dhe 5.

Kroacia (Kushtetuta)

Neni 73

Zgjedhjet për deputetët e Kuvendit kroat mbahen jo më vonë se 60 ditë pas skadimit të mandatit ose shpërndarjes së Kuvendit kroat.

Seanca e parë e Kuvendit kroat mbahet jo më vonë se njëzet (20) ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.

Kuvendi kroat konstituohet në seancën e parë me zgjedhjen e Kryetarit të tij nga shumica e deputetëve të pranishëm.

Sllovenia (Kushtetuta)

Neni 81

Mandati i Kuvendit Kombëtar

Kuvendi Kombëtar zgjidhet për katër (4) vjet.

Nëse mandati i Kuvendit Kombëtar përfundon gjatë një lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, mandati i tij përfundon gjashtë (6) muaj pas përfundimit të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, ose më herët nëse vetë Kuvendi Kombëtar vendos ashtu.

Zgjedhjet për Kuvendin Kombëtar thirren nga Presidenti i Republikës.

Kuvendi i ri Kombëtar zgjidhet jo më herët se dy muaj dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë para përfundimit të katër vjetëve nga data e seancës së parë të Kuvendit Kombëtar të mëparshëm.

Nëse Kuvendi Kombëtar shpërndahet, Kuvendi i ri Kombëtar zgjidhet jo më vonë se dy (2) muaj pas shpërndarjes së atij të mëparshëm.

Mandati i Kuvendit Kombëtar të mëparshëm përfundon në seancën e parë të Kuvendit të ri Kombëtar, e cila thirret nga Presidenti i Republikës jo më vonë se njëzet ditë pas zgjedhjes së Kuvendit të ri Kombëtar.

Mali i Zi (Kushtetuta)

Neni 88

Konstituimi i Kuvendit

Seancën e parë të përbërjes së porsazgjedhur të Kuvendit e fton kryetari i Kuvendit i përbërjes së mëparshme dhe mbahet jo më larg se 15 ditë nga dita e publikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Shqipëria (Kushtetuta)

Neni 65

1. Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.

[...]

Neni 67

1. *Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.*
2. *Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmbledhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.*

Rregullorja e Kuvendit

Neni 6

Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

1. *Kandidati për Kryetar të Kuvendit propozohet nga të paktën 15 deputetë. Një deputet nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat. Propozimi bëhet me shkrim, përmban nënshkrimet përkatëse dhe paraqitet në Sekretarinë e Përkohshme të Kuvendit.*
2. *Kryetari i Kuvendit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet me një raund të dytë, ku votohet për dy kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.*
3. *Votimi organizohet publikisht dhe drejtohet nga një komision votimi, i përbërë prej 5 deputetësh, që pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Anëtari më i vjetër në moshë kryen edhe detyrën e kryetarit të komisionit të votimit dhe shpall rezultatin e votimit.*
4. *Drejtuesi i seancës fton menjëherë Kryetarin e Kuvendit të zërë vendin e tij.*

Maqedonia e Veriut (Kushtetuta)

Neni 63

Deputetët në Kuvend zgjidhen për periudhë kohore prej katër vitesh. Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi. Mandati fillon të rrjedhë nga seanca konstitutive e Kuvendit. Kuvendi i porsazgjedhur mblidhet në seancën konstitutive më së voni 20 ditë pas zgjedhjeve të mbajtura. Seancën konstitutive e thirr Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme. Në qoftë se seanca konstitutive nuk thirret në afatën e paraparë, deputetët vetë mblidhen dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetënjëtë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Zgjedhjet për deputetë në Kuvend mbahen në 90 ditë e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Mandati i deputetëve në Kuvend mund të zgjatet vetëm në rast të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Me ligj caktohet papajtueshmëria dhe pazgjedhshmëria e funksionit të deputetit në Kuvend me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike. Kuvendi shpërndahet nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve

Serbia (Kushtetuta)

Neni 101

Zgjedhja e deputetëve dhe konstituimi i Kuvendit Kombëtar

Zgjedhjet për deputetë shpallen nga Presidenti i Republikës, 90 ditë para përfundimit të mandatit të Kuvendit Kombëtar, në mënyrë që zgjedhjet të përfundojnë brenda gjashtëdhjetë ditëve pasuese.

Seanca e parë e Kuvendit Kombëtar thirret nga Kryesuesi i Kuvendit nga përbërja e mëparshme, në mënyrë që seanca të mbahet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Në seancën e parë, Kuvendi Kombëtar konfirmon mandatet e deputetëve.

Kuvendi Kombëtar konstituohet me konfirmimin e mandateve të dy të tretave të deputetëve.

Kundër vendimit për konfirmimin e mandateve mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila vendos brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve.

Me konfirmimin e mandateve të dy të tretave të deputetëve, përfundon mandati i përbërjes së mëparshme të Kuvendit Kombëtar.

Bullgaria (Kushtetuta)

Neni 75

Kuvendi Kombëtar i sapozgjedhur thirret në seancën e parë nga Presidenti i Republikës brenda një muaji pas zgjedhjes së tij. Nëse Presidenti nuk e bën këtë, Kuvendi Kombëtar thirret nga një e pesta e deputetëve të Kuvendit Kombëtar.

Neni 76

1. Seanca e parë e Kuvendit Kombëtar hapet nga deputeti më i vjetër i pranishëm.

2. Në seancën e parë deputetët betohen si vijon:

“Betohem në emër të Republikës së Bullgarisë se do të respektoj Kushtetutën dhe ligjet e vendit dhe në të gjitha veprimet e mia do të udhëhiqem nga interesat e popullit. Betohem.”

3. Kuvendi Kombëtar zgjedh në të njëjtën seancë Kryetarin dhe Nënkryetarët e tij.

Rumania (Kushtetuta)

Neni 63

Mandati

1. Dhoma e Deputetëve dhe Senati zgjidhen për mandate katër-vjeçare, të cilat zgjaten me ligj [de jure] në rast mobilizimi, lufte, rrethimi ose gjendjeje të jashtëzakonshme derisa një situatë e tillë të marrë fund.

2. Zgjedhjet për Dhomën e Deputetëve dhe Senatin mbahen jo më vonë se tre muaj pas skadimit të mandatit të tyre ose shpërndarjes së Kuvendit.

3. Kuvendi i sapozgjedhur thirret nga Presidenti i Rumanisë jo më vonë se 20 ditë pas zgjedhjeve.

4. Mandati i Dhomave zgjatet deri në konstituimin e ligjshëm të Kuvendit të ri. Gjatë kësaj periudhe Kushtetuta nuk mund të ndryshohet, e as nuk mund të miratohen, ndryshohen ose shfuqizohen ligje organike.

5. Projektligjet qeveritare ose propozimet legislative që ishin në rendin e ditës së Kuvendit të mëparshëm barten në Kuvendin e ri.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

71. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, që përcakton se: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

72. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

73. Përveç kritereve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 [5] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”*

74. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) [...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

- (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- (b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- (c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.*

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

75. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton që më 15 prill 2025, përkatësisht në ditën e 19-të pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ, përmes Vendimit [nr. 01/794-2025] të 27 marsit 2025, Kuvendi mbajti Seancën e parë për konstituimin e Kuvendit, të kryesuar nga Kryesuesi, sipas

rendit të ditës ku ishte përcaktuar: (i) formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) dhënia e betimit të deputetëve; (iii) zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe (iv) zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit. Pas formimit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandatave të Deputetëve, ky i fundit paraqiti raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve, me të cilin konstatoi se në Legjislaturën IX të Kuvendit ishin certifikuar njëqind e njëzet (120) deputetë. Në po të njëjtën ditë, përkatësisht më 15 prill 2025, ku ishin të pranishëm 118 deputetë, u vendos në votim Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandatave të Deputetëve, i cili raport nuk kaloi, për shkak se pesëdhjetë e dy (52) deputetë votuan për, dyzet e gjashtë (46) kundër dhe njëmbëdhjetë (11) abstenuan. Si rezultat, më 17 prill 2025, seanca u ndërpre për ta vazhduar brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkak se në takimin konsultues nuk ishte arritur konsensus. Më 19 prill 2025, vazhdoi seanca konstituive, ku të pranishëm ishin njëqind e njëzet (120) deputetë, dhe në të cilën seancë Kryesuesi vendosi në votim formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve me përbërje të njëjtë, propozim ky që u votua nga 120 (njëqind e njëzet) deputetë të Kuvendit. Me këtë rast, Komisioni i Përkohshëm paraqiti raportin, me të cilin konstatoi vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe i njëjti u miratua në mënyrë unanime. Gjithashtu, në kuadër të kësaj seance, të gjithë deputetët dhanë betimin e tyre. Po të njëjtën ditë, përkatësisht më 19 prill 2025, Kryesuesi, vazhdoi me rendin e ditës dhe kërkoi nga Lëvizja Vetëvendosje! ta propozojë kandidatin për Kryetar/e të Kuvendit, ku kjo e fundit propozoi deputeten Albulena Haxhiu. Propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje! nuk kaloi për shkak se 57 (pesëdhjetë e shtatë) deputetë votuan për, 20 (njëzet) kundër dhe 3 (tre) abstenime. Pas votimit seanca u ndërpre për të vazhduar pas 15 (pesëmbëdhjetë) minutash me ç ‘rast, Kryesuesi vazhdoi me rendin e ditës dhe kërkoi nga Lëvizja Vetëvendosje! ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit, ku kjo e fundit propozoi deputeten Albulena Haxhiu. Propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje! nuk kaloi për shkak se 57 (pesëdhjetë e shtatë) deputetë votuan për, 19 (nëntëmbëdhjetë) kundër dhe 3 (tre) abstenime. Më pas, seanca konstituive vazhdoi më 21, 23, 25, 27 dhe 29 prill 2025, në të cilat seanca propozimi për kryetare të Kuvendit ishte i njëjtë dhe i cili propozim në këto 4 (katër) seanca nuk arriti votat e nevojshme nga deputetët.

76. Më 1 maj 2025, u mbajt seanca e radhës për konstituimin, në të cilën Kryesuesi pasi konstatoi se të pranishëm ishin 110 (njëqind e dhjetë) deputetë kërkoi nga partitë politike që të propozojnë nga 1 (një) anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë. Më pas, Kryesuesi ftoi deputetët që të votojnë anëtarët e Komisionit për Votim të Fshehtë, për të cilin komision 55 (pesëdhjetë e pesë) deputetë votuan për, një (1) deputet kundër dhe asnjë abstenim. Më pas, seanca konstituive vazhdoi më 3 dhe 5 maj 2025, respektivisht ku Kryesuesi kërkoi përsëri nga partitë politike që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë, të cilin e vendosi në votim, mirëpo ky propozim nuk kaloi në të dyja seancat për shkak se (i) në seancën e 3 majit, ku te pranishëm ishin 106 (njëqind e gjashtë) deputetë, 54 (pesëdhjetë e katër) deputetë votuan për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim, dhe (ii) në seancën e 5 majit, ku te pranishëm ishin 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) deputetë votuan për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim.
77. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Vendimi [i] Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprake dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar "transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025" janë në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 63 [Parimet e Përgjithshme], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], 70 [Mandati i Deputetëve], 72*

[Papajtueshmëria], dhe 74 [Ushtrimi i Funkcionit] të Kushtetutës. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në listën e 120 (njëqind e njëzet) deputetëve të verifikuar si të vlefshëm me mandatet e tyre hyjnë edhe disa deputetë që njëkohësisht ushtrojnë funksione ekzekutive duke specifikuar se kjo përbën shkelje të neneve 70 [Mandati i Deputetëve] dhe 72 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata thekson se ky pretendim nuk është ngritur në pajtim me pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës. Gjykata vëren që në pajtim me pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës në mënyrë që një kërkesë të vlerësohet nga Gjykata, e njëjta duhet të jetë e parashtruar nga ¼ e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në rrethanat e kësaj kërkesë nuk është rasti. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do të vazhdojë me vlerësimin e këtij pretendimi të parashtruesve të kërkesës.

78. Në vijim të kësaj, Gjykata rithekson që thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës është çështja e konstituimit të Kuvendit pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, dhe në kontekst të pranueshmërisë së kërkesës së tyre, rikujton që të njëjtit si në kërkesën e tyre fillestare si dhe në kërkesën e tyre të plotësuar kanë specifikuar që: *“çdo akt (veprim ose mosveprim) i Kuvendit gjatë ushtrimit të juridiksionit të tij kushtetues duhet të jetë objekt i kontrollit kushtetues me kusht që: (i) të ketë pasur votim për të; (ii) akti (veprimi ose mosveprimi) të ngrejë çështje kushtetuese dhe, së fundi, (iii) të jetë ndërmarrë në kohën kur ka pasur kuorum në Kuvend.”* Thënë këtë, parashtruesit e kërkesës nënvizojnë që moskonstituimi i Kuvendit përbën *“çështje fundamentale kushtetuese”*, për arsye se ndikon në funksionimin e organeve kushtetuese.
79. Në këtë kontekst, Gjykata vë në dukje që seanca konstituive e Kuvendit pas certifikimit të zgjedhjeve dhe përfundimi i saj pas përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore për konstituimin e Kuvendit shënon pikënisjen e fillimit të funksionimit të Kuvendit si organ përfaqësues, me funksione ligjvënëse, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse udhëhiqet në thelb nga neni 66 [Zgjedhja dhe Mandati], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkretarëve] dhe 70 [Mandati i Deputetëve] dhe 74 [Ushtrimi i Funkcionit] të Kushtetutës.
80. Në këtë rast, Gjykata, në mënyrë specifike i referohet neneve 66 dhe 67 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë si në vijim:

Neni 66
[Zgjedhja dhe Mandati]

1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.
 2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.
 3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.
 4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për atë sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
- [...]

Neni 67

[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve]

1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.
 2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
 3. Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
 4. Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.
81. Gjykata duke iu rikthyer vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës dhe në kontekst të juridiksionit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, ajo në parim vlerëson: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 42 të Ligjit dhe rregullin 74 të Rregullores së punës; (ii) natyrën e Aktit të kontestuar, përkatësisht nëse i njëjti kualifikohet si “vendim i Kuvendit”, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet përmes pikës 1.2 të nenit 42 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 74 të Rregullores së punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej 8 (tetë) ditëve pas miratimit të Aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
82. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë të Kuvendit, që është më shumë se minimumi i kërkuar me nenin 113, paragrafin 5 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht konsideron se është plotësuar kriteri për palën e autorizuar. Përderisa lidhur me natyrën e Aktit të kontestuar të Kuvendit, një qasje të ngjashme, Gjykata ndër të tjera, e kishte ndjekur edhe në aktgjykimet e rasteve [KO93/21](#), si dhe [KO160/23](#), ku kishte theksuar se kërkesat e dorëzuara në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës nga dhjetë (10) a më shumë deputetë kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi dhe ligji ose vendimi mund të kontestohet si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga procedura e ndjekur (shih, rastin e Gjykatës [KO93/21](#), me parashtrues *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, të 6 majit 2021, paragrafi 197; shih gjithashtu rastin [KO160/23](#), me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit Nr. Ref. L-VIII, SP-119 të datës 11 korrik 2023, për caktimin e seancës plenare të datës 13 korrik 2023, i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, paragrafi 49, paragrafi 50).
83. Megjithatë në rastin konkret, Gjykata së pari vë në dukje se kërkesa e tanishme dallon nga rrethanat e rasteve të sipërcituara. Kjo për shkak se në rrethanat e kërkesave të sipërcituara dhe atyre të dorëzuara dhe shqyrtuara nga Gjykata sipas juridiksionit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, aktet e kontestuara nga parashtruesit e kërkesës ishin nxjerrë nga organet e Kuvendit apo nga vetë Kuvendi, vendimmarrja e të cilave buronte nga një Kuvend i konstituuar dhe funksional në kuptimin e autorizimeve të tij ligjvënëse, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse, të përcaktuara me Kushtetutë.
84. Përderisa në kontekstin e rrethanave që ndërliidhen me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, veprimet apo mosveprimet e deputetëve të zgjedhur të përmbledhura në dokumentin e titulluar “*transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së*

Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025” ishin zhvilluar gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të filluar më 15 prill 2025 e cila si akt kushtetues në kuptim të paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës nuk ka përfunduar për shkak të moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe Nënkyetarëve të tij.

85. Gjykata vlerëson se “*seancat*” e specifikuara në kërkesën e parashtruesve të kërkesës konsiderohen si një seancë unike të cilat nuk janë të natyrës së një seance të zakonshme plenare të Kuvendit pas konstituimit të tij. Thënë këtë, Gjykata rithekson se Seanca Konstituive është një akt kushtetues, e cila konsiderohet si e realizuar vetëm pas përfundimit të (i) verifikimit të mandateve të deputetëve, (ii) dhënies së betimit të deputetëve, dhe (iii) zgjedhjes së kryetarit/es dhe Nënkyetarëve të tij. Rrjedhimisht, me zgjedhjen e Kryetarit/es dhe Nënkyetarëve, Kuvendi mund të konsiderohet si i konstituuar.
86. Prandaj, në kontekstin e vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata rithekson që rrethanat e kërkesës së parashtruesve të kërkesës dallojnë nga rastet e vendosura nga Gjykata në kuadër të juridiksionit të saj të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës duke konsideruar që “*seancat e lartcekura*” ishin zhvilluar në kuadër të seancës për konstituimin e Kuvendit dhe ku si pika të rendit të ditës në agjendë ishin (i) formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) dhënia e betimit të deputetëve; (iii) zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe (iv) zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit. Rrjedhimisht, marrë për bazë këtë vlerësim dhe konstatimin që seanca për konstituimin e Kuvendit nuk është përfunduar, Gjykata vlerëson se çështja e Seancës Konstituive të Kuvendit përbën çështje kushtetuese, e cila duhet t’i nënshtrohet vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], nenit 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenit 74 [Ushtimi i Funksionit] të Kushtetutës.
87. Në përfundim, Gjykata rithekson që Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës është një akt kushtetues e cila realizohet vetëm pas përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe të nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës.
88. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesve të kërkesës ndërlidhur me seancën konstituive të Kuvendit, të filluar më 15 prill 2025, e cila nuk ka përfunduar për shkak të moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij është e pranueshme për shqyrtim dhe në vijim, Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e kërkesës së parashtruesve të kërkesës.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

89. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë që “*seancat e zhvilluara*” për konstituimin e Kuvendit të reflektuara në dokumentin e titulluar “*transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025*” janë zhvilluar në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 63 [Parimet e Përgjithshme], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], 70 [Mandati i Deputetëve], 72 [Papajtueshmëria] dhe 74 [Ushtimi i Funksionit] të Kushtetutës.

90. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë që (i) të anulohen si “*jokushtetuese të gjitha vendimet e Kuvendit të Kosovës për ndryshimin e rendit të ditës të 8 prillit 2025*”; (ii) të rikthehet “*situata kushtetuese e datës 8 prill 2025 dhe të urdhërohet veprimi në përputhje me udhëzimet e Aktgjykimit KO119/14 lidhur me procedurën kushtetuese që duhet ndjekur për konstituimin e Kuvendit të Kosovës pas çdo zgjedhjeje të përgjithshme*”; (iii) të kufizohet mundësia e propozimit të të njëjtit kandidat për Kryetar të Kuvendit të Kosovës më shumë se një herë; dhe (iv) të përcaktohet një afat kohor brenda të cilit Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet pas mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme.
91. Përderisa deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! në komente të tyre të dorëzuara në Gjykatë, dhe në mënyrë specifike ndërlidhur me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve, si dhe “*detyrës së deputetit*” gjatë Seancës Konstituive, theksuan se (i) “*deri sa nuk zgjedhën Kryetari dhe nënkryetarët, nuk ka Kuvend të konstituuar dhe puna e legjislativit nuk mund të fillojë*”; dhe (ii) deputetët e kanë detyrë parësore konstituimin e Kuvendit dhe se është detyrim i çdo deputeti “*të bashkëpunojë aktivisht në procesin e konstituimit të Kuvendit pasi që ky është një hap themelor për funksionimin e institucioneve demokratike*.” Në anën tjetër, deputeti Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës lidhur me propozimin e kandidates për Kryetar të Kuvendit theksoi që: “[...] ashtu siç nuk është e përhershme e drejta për të caktuar mandatarin vetëm partia fituese sipas rezultatit të zgjedhjeve, nuk mund të jetë e përhershme as e drejta e partisë së parë/grupit më të madh parlamentar të dalë nga zgjedhjet që të propozojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme Kryetarin e Kuvendit, sepse një e drejtë e tillë për të propozuar Kryetarin e Kuvendit, në pikëpamje kushtetuese nuk mund të shërbejë si mekanizëm për të bllokuar konstituimin e Kuvendit [...]”.
92. Duke marrë për bazë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, si dhe argumentet dhe kundërgargumentet e palëve të interesuara, Gjykata konsideron se çështje kushtetuese dhe objekt i vlerësimit të kësaj kërkesë përbën Seanca për konstituimin e Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, dhe e cila nuk ka përfunduar për shkak të moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe Nënkryetarëve të Kuvendit. Prandaj në këtë kontekst Gjykata, do të fillojë me (i) vlerësimin e çështjes ndërlidhur me konstituimin e Kuvendit dhe afatit për konstituimin e tij, për të vazhduar me vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhen me (ii) ndryshimin e rendit të ditës së seancës konstituive dhe propozimin e Kryesuesit për themelimin e “*Komisionit për Votim të Fshehtë*”.
93. Gjykata sërish rikujton që seanca e konstituimit të Kuvendit, konsiderohet e realizuar vetëm pas zgjedhjes së Kryetarit/es dhe Nënkryetarëve të tij. Megjithatë, ashtu siç është elaboruar si më sipër, gjatë seancave të mbajtura për konstituimin e Kuvendit është arritur që të realizohen vetëm verifikimi i mandatave të deputetëve dhe dhënia e betimit të tyre. Deri në parashtrimin e kërkesës nga parashtruesit e kërkesës më 22 maj 2025 ishin mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) seanca, të cilat nuk rezultuan në zgjedhjen e Kryetarit/es dhe të Nënkryetarëve të Kuvendit. Për më tepër Gjykata vë në dukje se edhe pas parashtrimit të kërkesës së parashtruesve të kërkesës, Kuvendi ka vazhduar me mbajtjen e seancave për konstituimin e Kuvendit, megjithatë deri më këtë datë, të njëjtat nuk kanë rezultuar në zgjedhjen së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij. Si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve, Kuvendi nuk ka arritur të konstituohet dhe për rrjedhojë i njëjti nuk është funksionalizuar si organ përfaqësues me autorizime ligjvënëse, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse të përcaktuara me Kushtetutë. Thënë këtë konstituimi i Kuvendit dhe themelimi i organeve tjera kushtetuese që burojnë nga Kuvendi i shërbejnë ruajtjes së rendit kushtetues duke garantuar ndërveprim të të gjitha pushteteve në shërbim të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.
94. Në të tilla rrethana, kur Kuvendi nuk arrin të përmbushë funksionet e tij bazike, përfshirë konstituimin dhe zgjedhjen e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij, kjo përbën rrezik të

drejtpërdrejtë për parimin e përfaqësimit dhe për ekuilibrin e pushteteve, dhe kërkon një përgjigje të qartë dhe parimore nga Gjykata.

95. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata specifikon se ajo nuk është thirrur për të zgjidhur një mosmarrëveshje politike ndërmjet grupeve parlamentare, por për të garantuar se proceset themelore kushtetuese, siç në rrethanat e kërkesës është konstituimi i Kuvendit, i cili konsiderohet si i përfunduar me zgjedhjen e Kryetarit/es dhe Nënkryetarëve të zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe funksionalitetit, si dhe gjithmonë në pajtim me parimet dhe vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
96. Për këtë qëllim, Gjykata fillimisht do të elaborojë parimet dhe vlerat e përgjithshme të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për të vazhduar me elaborimin e dispozitave relevante kushtetuese që ndërlidhen me konstituimin e Kuvendit dhe standardet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe standardet ndërkombëtare.

II. Parime të përgjithshme kushtetuese

97. Bazuar në nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit] të Kushtetutës, Republika e Kosovës është “*shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm*”.
98. Neni 2 [Sovranitetit] i Kushtetutës përcakton që sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të popullit, në pajtim me Kushtetutën. Mënyrë tjetër e ushtrimit të sovranitetit nga populli janë referendumet ose format e tjera të pajtueshme me Kushtetutën.
99. Në këtë kontekst, përkufizimi “*demokratik*” i shtetit të Kosovës, ndër të tjera dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, plotësohet përmes 4 (katër) neneve thelbësore kushtetuese, përkatësisht nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenit 7 [Vlerat] dhe nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (shih, rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22, parashtrues të kërkesës KO100/22, *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; me parashtrues të kërkesës KO101/22, *Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Aktgjykim, i 24 marsit 2023, paragrafët 154-155).
100. Neni 3 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, ndër të tjera, saktëson që (i) Republika e Kosovës, qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore; dhe (ii) ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës, bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
101. Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, dhe mes tjerash saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave

shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

102. Neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, saktëson që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit shtetëror dhe barazisë gjinore.
103. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burimi i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti.
104. Neni 63 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës përcakton që: *“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”* Përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, ndërsa deputetët si përfaqësues të popullit nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues. Si institucion ligjvënës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, Kuvendi ka një mori të kompetencave të cilat janë të përcaktuara specifikisht në Kushtetutë, e këto përfshijnë kompetenca ligjvënëse, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse. Në këtë aspekt, në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate është theksuar se: *“Demokracia, “vox populi” (zëri i popullit), kërkon zgjedhjen e atyre që do të përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky [Kuvendi] është subjekti më i lartë drejtues i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. [...]”* (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO119/14, parashtrues *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014*, Aktgjykim, i 21 gushtit 2014, paragrafi 49).
105. Kësisoj, Kushtetuta ka përcaktuar demokracinë e Republikës së Kosovës si demokraci parlamentare, duke i dhënë Kuvendit funksion përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës (shih, ndër tjerash nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës). Në veçanti, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit janë deputetët e Kuvendit të zgjedhur në zgjedhje të lira dhe demokratike. Ushtrimi i sovranitetit përmes të zgjedhurve të popullit është modaliteti kryesor dhe më i përhapur për të shprehur atë se çfarë *“buron nga populli”* dhe për ta reflektuar atë në veprime dhe vendime konkrete përmes sistemit të demokracisë përfaqësuese. Përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, ndërsa deputetët si përfaqësues të popullit nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues (shih, ndër tjerash nenin 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës). Në këtë mënyrë, Kuvendi si përfaqësues i sovranit, sovranitetin e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, në pajtim me Kushtetutën, e cila gjithashtu buron nga populli dhe manifeston vullnetin e popullit për një shtet të lirë, demokratik e paqedashës, atdhe i të gjithë qytetarëve të vet, qytetarë të barabartë në të drejta dhe me barazi para ligji, që do të jetojnë në shtetin e tyre si shtet i mirëqenies ekonomike e prosperitetit social, i cili shtet si anëtar i denjë i familjes së shteteve të lira e paqedashëse kontribuon në stabilitetin rajonal e evropian përmes bashkëpunimit e fqinjësisë së mirë dhe që synon integrim Euro-Atlantik (shih Preambulën e Kushtetutës). Këto ideale të sovranit të materializuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të mbesin zotime të papërmbushura kurdo dhe çdoherë që përfaqësuesit e sovranit, nuk udhëhiqen nga parimi i bashkëpunimit me (mirë)besim dhe nuk angazhohen në mënyrë konstruktive dhe mbështetëse për zgjidhjen e cilësdo situatë që mund të krijojë apo që ka krijuar jofunksionalitet të organit përfaqësues apo institucioneve tjera kushtetuese e shtetërore.

106. Hapi i parë në formimin e institucioneve kushtetuese pas zgjedhjeve, sikurse është përcaktuar në Kushtetutë, përkatësisht pas shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve, është konstituimi i Kuvendit.
107. Gjykata rikujton se në rastin KO119/14, në të cilin rast është bërë interpretimi i paragrafit 1 të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] dhe paragrafit 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës kishte konstatuar se e drejta e propozimit të kandidatit për Kryetar Kuvendi i takonte grupit më të madh parlamentar, si grup i dalë nga zgjedhjet sikurse certifikohet në aktin e shpalljes zyrtare të rezultatit të tyre (shih, paragrafin 116 të Aktgjykimit në rastin KO119/14).
108. Në vijim, Gjykata poashtu vëren se paragrafi 2 i nenit 67 të Kushtetutës, përcakton që Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Gjykata vlerëson se kjo dispozitë kushtetuese i jep të drejtën grupit më të madh parlamentar që të bëjë propozimin e kandidatit për Kryetar/e Kuvendi, por njëkohësisht vendos detyrimin kushtetues që ky propozim duhet të marrë miratimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht 61 (gjashtëdhjetë e një) vota. Në vijim, ashtu siç është theksuar edhe në Aktgjykimin në rastin KO119/14, Gjykata vë në dukje se *“askund në Kushtetutë nuk parashihet që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të shkaktonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare”* (shih, paragrafin 126 të Aktgjykimit në rastin KO119/14).
109. Në kontekst të konstituimit të institucioneve shtetërore, Gjykata ka theksuar që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlidhet me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo të bllokojë themelimin e institucioneve dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre, sepse vetëm në atë mënyrë mund të zbatohet drejt parimi i ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë (shih, rastin KO72/20, parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, i 30 prillit 2020, paragrafi 475).
110. Kësisoj, dhe në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata ka theksuar rëndësinë e interpretimit të Kushtetutës përkitazi me themelimin e organeve kushtetuese. Për më tepër, Gjykata ka vënë theks në themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve, ku legjitimohen përfaqësuesit e zgjedhur të popullit për një mandat kushtetues përfaqësimi 4 (katër) vjeçar në Kuvendin e Republikës, dhe më pas, Qeverinë e tyre, të zgjedhur përmes Kuvendit, sipas procedurave të përcaktuara në Kushtetutë.
111. Përderisa funksionimi demokratik i institucioneve shtetërore është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike, të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar. Çdo pengesë ose mungesë bashkëpunimi në përmbushjen e detyrimeve dhe autorizimeve kushtetuese, është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës KO72/20, cituar më lart, paragrafët 476-478).
112. Sikurse e ka theksuar edhe Komisioni i Venecias në një Opinion për Malin e Zi, e që është relevante për rrethanat e këtij rasti: *“[...] është parimi i bashkëpunimit lojal në mes të institucioneve shtetërore i cili duhej të ofronte një zgjidhje.” Vetëm respekti i ndërsjellë mund të çojë në vendosjen e praktikave të pranuar reciprokisht, të cilat janë në përputhje me Trashëgiminë Kushtetuese Evropiane dhe që i mundësojnë një vendi të*

shmangë dhe të kapërcejë krizat me qetësi” (shih, Opinionin [CDL-AD\(2022\)053](#) të Komisionit të Venecias për Malin e Zi në lidhje me amendamentet e Ligjit për Presidentin, miratuar më 16-17 dhjetor 2022, paragrafi 29).

113. Në vijim, Komisioni i Venecias ka specifikuar që: *“Respektimi i sundimit të ligjit nuk mund të kufizohet vetëm në zbatimin e dispozitave të shprehur dhe formale të ligjit dhe të Kushtetutës. Ai nënkupton gjithashtu sjellje dhe praktika kushtetuese, të cilat lehtësojnë zbatimin e rregullave formale nga të gjitha organet kushtetuese dhe respektin e ndërsjellë mes tyre.”* (shih, Opinionin [CDL-AD\(2012\) 026](#) për Rumaninë në lidhje me përputhshmërinë me parimet kushtetuese dhe Sundimin e Ligjit të veprimeve të ndërmarra nga Qeveria dhe Parlamenti i Rumanisë në raport me institucione të tjera shtetërore dhe urdhrin emergjent të Qeverisë për ndryshimin e Ligjit nr. 47/1992 për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe urdhrin emergjent të Qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 3/2000 për organizimin e referendumit, miratuar më 14-15 dhjetor 2012, paragrafi 73).
114. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka theksuar se demokracia përfaqësuese është një element thelbësor i rendit publik evropian dhe se *“të drejtat e garantuara sipas Nenit 3 të Protokollit Nr. 1 janë thelbësore për vendosjen dhe ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë, të qeverisur nga sundimi i ligjit, dhe për rrjedhojë kanë një rëndësi parësore në sistemin e Konventës.”* (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, Aktgjykim, i 2 marsit 1987, paragrafi 47 dhe *Ždanoka kundër Letonisë* [DHM], nr. 58278/00, Aktgjykim, 16 marsit 2006, paragrafët 98 dhe 103). Në vijim, GJEDNJ në parim ka nënvizuar se: *“Ekziston një lidhje e ngushtë midis një demokracie politike efektive dhe funksionimit efektiv të Parlamentit. [...] Rregullat që kanë të bëjnë me funksionimin e brendshëm të Parlamentit janë shprehje e parimit të mirëvërtetuar të autonomisë së Parlamentit. Në përputhje me këtë parim, Parlamenti ka të drejtën — me përjashtim të pushteteve të tjera dhe brenda kufijve të kornizës kushtetuese — të rregullojë çështjet e tij të brendshme, për shembull përbërjen e organeve të tij”* (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mugemanganbo kundër Belgjikës*, nr. 310/15, Aktgjykim, i 10 korrikut 2020, paragrafi 74).
115. Rrjedhimisht dhe në vlerësimin e çështjes kushtetuese që do të vlerësohet nga Gjykata do të aplikohen parimet e lartcekura kushtetuese si dhe përcaktimet e specifikuara me Kushtetutë që ndërlidhen me konstituimin e Kuvendit, përfshirë ato të vendosura dhe elaboruara përmes praktikës së deritanishme të Gjykatës.

(i) Lidhur me konstituimin e Kuvendit dhe qafatin për konstituimin e tij

116. Fillimisht, Gjykata rithekson përcaktimin kushtetues të demokracisë parlamentare dhe rolin esencial të Kuvendit me kompetenca ligjvënëse, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse. Ky rol esencial manifestohet qartë në nenin 2 [Sovraniteti], paragrafin 2 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 70 [Mandati i Deputetëve], nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] përfshirë edhe ato ndërlidhur me paragrafin 1 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit], paragrafin 3 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe paragrafin 1 të nenit 140 [Banka Qendrore e Kosovës] të Kushtetutës, që përfshijnë kompetencën e Kuvendit për zgjedhjen e krerëve të këtyre institucioneve dhe raportimit të tyre në Kuvend. Kjo frymë, në esencë, përshkon gjithë tekstin kushtetues. Vetë natyra e kësaj demokracie ndjek një lloj demokracie konsensusi, defavorizon dhe përjashton mundësinë që Kuvendi si organ përfaqësues të shndërrohet në legjislaturë jo funksionale si rezultat i bllokimeve procedurale.

117. Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës, Kuvendi zgjidhet me mandat katër (4) vjeçar. Pas përfundimit të rregullt të mandatit të Kuvendit, vendi shkon automatikisht në zgjedhje. Thënë këtë, qëllimi i një legjislature bazuar në Kushtetutë, është përfundimi i mandatit 4 (katër) vjeçar të saj. Në zgjedhje të reja, populli voton dhe zgjedh legjislaturën e re, me bindjen që ajo legjislaturë do t'i përfaqësojë për 4 (katër) vitet e tjera të radhës. Kjo paraqet ciklin e rregullt të zgjedhjes së përfaqësuesve të popullit në Kuvend. Përkundër këtij cikli të rregullt të demokracisë përfaqësuese, mandati i Kuvendit mund të mbarojë para përfundimit të mandatit të rregullt 4 (katër) vjeçar, vetëm sipas rregullimit të përcaktuar përmes nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, ku specifikisht përcaktohen 3 (tri) situata të shpërndarjes të detyrueshme të Kuvendit dhe, një (1) situatë të mundshme të shpërndarjes së Kuvendit. Përfundimisht, bazuar në paragrafin 4 të nenit 66 të Kushtetutës, mandati i Kuvendit mund të vazhdohet edhe përtej mandatit të rregullt kushtetues 4 (katër) vjeçar, në rrethana të Gjendjes së Jashtëzakonshme (shih, rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafi 350).
118. Gjykata, në kuptim të detyrimit për bashkëpunim ka theksuar se të gjitha pushtetet pa përjashtim, qofshin ato pjesë të trekëndëshit klasik të ndarjes së pushteteve, qofshin ato pjesë tjetër e rëndësishme e strukturës së shtetit, kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën në të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto pushtete kanë për obligim që të kryejnë detyrat e tyre publike me qëllim të jetësimit të vlerave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar të funksionojë Republika e Kosovës. Në këtë aspekt, bashkëpunimi besnik në mes të institucioneve kushtetuese/publike paraqet detyrim kushtetues dhe besnikëri ndaj betimit formal e publik me rastin e marrjes së përgjegjësisë kushtetuese nga secili bartës i funksionit përkatës publik (shih, rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafi 353).
119. Duke u bazuar në parimet e lartcekura, Gjykata vëren se sipas paragrafit 1 të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës përcaktohet se Kuvendi ka 120 (njëqind e njëzet) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
120. Sipas paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës përcaktohet se Kuvendi i Kosovës, zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e Seancës Konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.
121. Tutje, sipas paragrafit 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
122. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës, përmes të cilëve përcaktohet që: *“Deputetë e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues”* dhe *“Mandati i deputetit të Kuvendit të Kosovës fillon ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve.”*
123. Në vijim, Gjykata i referohet edhe nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, i cili përcakton që: *“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”*

124. Duke iu rikthyer përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës përmes të cilave specifikohet se: *“Kuvendi i Kosovës zgjidhet më mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.”* Në versionin në gjuhën angleze të Kushtetutës, dispozita e nenit 66 është formuluar si vijon: *“The Assembly of Kosovo shall be elected for a mandate of four (4) years, starting from the day of the constitutive session, which shall be held within thirty (30) days from the official announcement of the election results”*. (Gjykata sqaron se ky formulim në gjuhën angleze – *“shall be held”* – paraqet një normë me karakter detyrues, dhe jo fakultativ, sipas përdorimit të standardizuar të gjuhës normative dhe kushtetuese edhe në të drejtën anglo – saksone, sipas *Black’s Law Dictionary*, *“shall”* is *“mandatory”*, not *“permissive”*).
125. Gjykata vë në dukje se në praktikën e saj të deritanishme gjyqësore, kjo e fundit nuk ka interpretuar apo vlerësuar paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës që ndërlidhet me konstituimin e Kuvendit pas zgjedhjeve. Megjithatë, lidhur me këtë, Gjykata rikujton se në rastin KO119/14 ajo ka bërë interpretimin e paragrafit 1 të nenit 64 dhe paragrafit 2 të nenit 67 të Kushtetutës, ku kishte vlerësuar se e drejta e propozimit të kandidatit për Kryetar Kuvendi i takonte grupit më të madh parlamentar, si grup i dalë nga zgjedhjet sikurse certifikohet në aktin e shpalljes zyrtare të rezultatit të tyre (shih, paragrafët 111-118 të Aktgjykimit në rastin KO119/14).
126. Rrjedhimisht, Gjykata në rastin KO119/14 ka nënvizuar si në vijim (i) *“[...] seanca konstituive e Kuvendit nuk mund të konsiderohet se është realizuar plotësisht, nëse Kuvendi nuk e ka zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e saj* (shih, paragrafin 109 të Aktgjykimit në rastin KO119/24” dhe (ii) *“zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe e [deputetëve] është parakusht që Kuvendi të fillojë të funksionojë si organ legjislativ. Kjo kërkon nga të gjithë deputetët që të jenë të pranishëm dhe të votojnë, në mënyrë që të konstitudojnë Kuvendin”* (shih, paragrafin 123);” dhe (iii) *“Është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese në lidhje me Rregulloren relevante të Kuvendit dhe të bëjnë Kuvendin funksional”* (shih, paragrafin 127).
127. Në kuptim të kërkesës së parashtresve të kërkesës, Gjykata vlerëson se paragrafi 2 i nenit 67 të Kushtetutës ka një rëndësi themelore në garantimin e përfaqësimit të vullnetit elektoral dhe të legjitimitetit institucional në kuadër të procesit të konstituimit të Kuvendit. Sipas interpretimit kushtetues, paragrafi 2 i nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] i Kushtetutës përmban dy (2) elemente të pandashme, përkatësisht (i) të drejtën e grupit më të madh parlamentar për të propozuar Kryetarin/en e Kuvendit (shih, interpretimin e Gjykatës në rastin KO119/14, paragrafi 116); dhe që (ii) kandidati /ja i/e propozuar zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Thënë këtë dhe sa i përket elementit të dytë, Gjykata vlerëson se kërkesa që Kryetari i Kuvendit të zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përcakton një standard të qartë dhe objektiv të legjitimitetit kushtetues.
128. Lidhur me zgjedhjen e Nënkyetarëve, Gjykata Kushtetuese në rastin [KO84/18](#) ka sqaruar që bazuar në paragrafin 3 të nenit 67 të Kushtetutës, për zgjedhjen e 3 (tre) Nënkyetarëve, duhet të plotësohen dy kushte, dhe atë, (i) të propozohen nga tri grupet me të mëdha parlamentare dhe (ii) të marrin votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit. Sa i përket kushtit të parë, Gjykata vëren se Kushtetuta, në nenin 67, paragrafi 3, në mënyrë të qartë përcakton se e drejta për të propozuar 3 (tre) kandidate për pozita të Nënkyetarëve u takon ekskluzivisht 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare. Gjykata vlerëson se e drejta e 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare për të propozuar kandidatet për pozitën e Nënkyetarit të Kuvendit është thelbësore për ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë në konstituimin e Kuvendit, të qeverisur nga sundimi i ligjit. Gjykata në vijim kishte specifikuar që (i) *“përderisa e*

drejta e propozimit u takon 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare, këto grupe jo detyrimisht janë të kufizuara që të propozojnë kandidatë nga grupi i tyre parlamentar” dhe (ii) “paragrafi 3, i nenit 67 të Kushtetutës, mundëson një liri të gjere të propozimit të kandidatit për pozitën e nënkryetarit të Kuvendit duke mos kufizuar propozimin nga një grup i caktuar parlamentar.” Tutje, Gjykata po në këtë rast kishte specifikuar që “për dallim nga gjuha e paragrafit 3 të nenit 67 që mundëson liri me të gjere të propozimit, në paragrafin 4 të nenit 67, të Kushtetutës shprehimisht përcaktohet se “2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, dhe ata zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputeteve”. Më tutje, në të njëjtin paragraf, Kushtetuta shprehimisht përcakton se “njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë. Ndërsa, sa i përket kushtit të dytë, Gjykata rikujton se për t’u konsideruar të zgjedhur të propozuarit nga grupet parlamentare nuk zgjedhen automatikisht nënkryetarë të Kuvendit pas propozimit të grupeve parlamentare por i nënshtrohen procesit të votimit në Kuvend. Të propozuarit e grupeve parlamentare zgjedhen nënkryetarë të Kuvendit vetëm nëse marrin votat e shumicës së të gjithë deputeteve të Kuvendit.” (shih, rastin e Gjykatës KO84/18, parashtrues Albin Kurti dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V-145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim, i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 94-96).

129. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, Gjykata konsideron që shumica e kërkuar për zgjedhjen e Kryetarit/es së Kuvendit është “me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit” përkatësisht 61 (gjashtëdhjetë e një) vota në një Kuvend prej 120 (njëqind e njëzet) deputetësh. Shmangia nga ky standard kushtetues, në çfarëdo rrethane, cenon rendin kushtetues dhe legjitimitetin kushtetues të procesit të konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, mos arritja e shumicës së kërkuar për zgjedhjen e kandidatit të propozuar nga grupi më i madh parlamentar për Kryetar të Kuvendit, përbën në anën tjetër, dështim të deputetëve për të përmbyllur me sukses seancën konstituive, edhe në kuptim të detyrimit kushtetues të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës.
130. Gjykata rithekson se e drejta e grupit më të madh parlamentar për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit është vendosur përmes Aktgjykimit në rastin KO119/14. Megjithatë, Gjykata nënvizon që e drejta për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit është e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me arritjen e shumicës së votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Si e tillë kjo e drejtë për propozimin e kandidatit për Kryetar/e të Kuvendit përbën njëkohësisht edhe detyrim për grupin më të madh parlamentar për bashkëpunim në mirëbesim dhe konsultim konstruktiv me grupet e tjera parlamentare për të gjetur konsensusin apo kompromisin e nevojshëm dhe se kjo e drejtë në asnjë mënyrë nuk mund të rezultojë në bllokimin e konstituimit të Kuvendit. Në këtë kontekst, ky detyrim për bashkëpunim kontruktiv në mirëbesim që buron nga vetë neni 67 i Kushtetutës, ndërlidhet ngushtë edhe me detyrimin e përcaktuar në nenin 74 të Kushtetutës, sipas të cilit deputetët e Kuvendit ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit. Njëkohësisht, një detyrim i tillë vlen edhe për grupet tjera parlamentare të cilët në frymën e bashkëpunimit dhe konsultimeve konstruktive propozojnë kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit, të cilët bazuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës, po ashtu zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve.

131. Më tej, Gjykata duke i'u rikthyer përcaktimeve në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës thekson se vetë struktura e kësaj dispozite kushtetuese nënkupton se mbajtja e seancës konstituive brenda afatit tridhjetë (30) ditor, nuk është mundësi formale apo orientuese, por detyrim kushtetues që lidhet ngushtë me fillimin e mandatit të legjislaturës së re.
132. Kërkesa nga paragrafi 1 i nenit 66 të Kushtetutës, që Kuvendi të mbajë Seancën Konstituive brenda tridhjetë (30) ditëve nuk do të thotë vetëm që deputetët e zgjedhur duhet të mblidhen fizikisht në sallë. Kuptimi i kësaj norme duhet të jetë substancial dhe funksional, duke nënkuptuar që brenda këtij afati duhet të realizohen të gjitha veprimet kushtetuese që rezultojnë në konstituimin e Kuvendit. Këto përfshijnë: (i) verifikimin e mandateve të deputetëve të zgjedhur, (ii) dhënien e betimit nga ana e tyre dhe (iii) zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe (iv) zgjedhjen e Nënkyetarëve të Kuvendit. Thënë këtë, Gjykata rithekson që pa përfundimin me sukses të këtyre veprimeve kushtetuese, Kuvendi nuk mund të konsiderohet juridikisht i konstituuar dhe, rrjedhimisht, nuk mund të ushtrojë asnjë nga funksionet që Kushtetuta i ka caktuar.
133. Gjykata vlerëson që një Seancë Konstituive që mbahet, por nuk e zgjedh Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit, nuk arrin efektin juridik që i ka përcaktuar Kushtetuta, dhe është seancë e papërfunduar dhe rrjedhimisht nuk përmbush kërkesën e paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës.
134. Gjykata gjithashtu vëren që paragrafi 2 i nenit 70 [Mandati i Deputetëve] i Kushtetutës përcakton që *"mandati i deputetit të Kuvendit të Kosovës fillon ditën certifikimit të rezultatit të zgjedhje(s)-ve."*
135. Sikurse është theksuar në vendimet e mëhershme të Gjykatës, kur norma kushtetuese i nënshtrohet interpretimit nga Gjykata, ajo si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës (shih, paragrafin 6 të nenit 4 dhe paragrafin 1 të nenit 112 të Kushtetutës), niset nga parimi që Kushtetuta është një akt juridik unik, normat e së cilës janë të ndërlidhura dhe ndërveprojnë në mënyrë koherente e logjike. Kjo ndërlidhje dhe ky ndërveprim, i mundëson Gjykatës të kuptojë qëllimin e kushtetutbërësit dhe të nxjerrë kuptimin e normave kushtetuese (shih, ndër tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafi 475).
136. Gjykata në dritën e leximit të përbashkët të përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], paragrafit 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] paragrafit 2 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës vë në dukje se mandati i Kuvendit si organ kushtetues dhe mandati i deputetit si përfaqësues i zgjedhur i sovranit në Kuvend janë një mandat i ndërlidhur.
137. Prandaj, fillimi i mandatit të deputetit sipas paragrafit 2 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] dhe fillimi i mandatit të Kuvendit sipas paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], të Kushtetutës i nënshtrohen kohëzgjatjes (4) katërvjeçare.
138. Në vijim të kësaj, Gjykata nënvizon se bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës fillimin e mandatit të Kuvendit e kushtëzon me ditën e mbajtjes së Seancës Konstituive, përderisa paragrafi 2 i nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës fillimin e mandatit të deputetit e kushtëzon me ditën e certifikimit të rezultatit zgjedhor. Fillimi i mandatit të deputetit sipas paragrafit 2 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] duhet kuptuar edhe në kontekst të kërkesave të pikës 1, paragrafi 3 të nenit 70, kur përcaktohet se mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse nuk bën betimin. Thënë këtë, ky mandat nuk mund të ushtrohet në mënyrë të plotë pa përmbushjen e kërkesave të paragrafit 3 të po këtij neni, veçanërisht pa dhënien e betimit, i cili është pjesë përbërëse e procesit konstituiv dhe që, po ashtu, realizohet në Seancën Konstituive. Kësisoj, mandati i

deputetit dhe mandati i Kuvendit janë të ndërlidhur, pasi që deputetët përfaqësojnë sovranin, por ky përfaqësim nuk mund të jetësohet në aspekt institucional pa konsituimin e Kuvendit.

139. Në leximin e paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje se Kushtetuta i referohet Seancës Konstituive si një seancë unike. Kësisoj, kushtetutëbërësi ka parashikuar që Seanca Konstituive të mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve. Për më tepër, edhe pse Kushtetuta sipas paragrafit 3 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], autorizon Presidentin për thirrjen e Seancës Konstituive, megjithatë ruan të drejtën, por gjithashtu përcakton edhe obligimin që Kuvendi të mblidhet vetë, nëse Presidenti nuk është në gjendje të thërras Seancën Konstituive. Ky përjashtim, përkatësisht kërkesa që Kuvendi të mblidhet për Seancën Konstituive pa thirrjen nga Presidenti është tregues i qartë që kushtetutëbërësi ka evituar barrierat e mundshme formale që do të mund të shndërroheshin në pengesa për mbajtjen e seancës konstituive, përkatësisht konstituimin e Kuvendit pas zgjedhjeve të përgjithshme.
140. Duke marrë për bazë elaborimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se afati 30 (tridhjetë) ditë i përcaktuar nga kushtetutëbërësi në paragrafin 1 të nenit 66, nuk mund të trajtohet si afat brenda të cilit vetëm duhet provuar konstituimi i Kuvendit, porse ky afat, në ndërlidhje me përcaktimet në nenin 2, paragrafin 2 të nenit 4, nenin 7, nenin 65, nenin 74, paragrafin 1 të nenit 134, paragrafin 3 të nenit 136 dhe paragrafin 1 të nenit 140 të Kushtetutës, është afat brenda të cilit duhet të konstituohet Kuvendi.
141. Gjykata, në rastin KO119/14 lidhur me atë se cilat janë veprimet që duhet të ndërmerren për të realizuar me sukses seancën konstituive kishte theksuar që: *“zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe e deputetëve është parakusht që Kuvendi të fillojë të funksionojë si organ legjislativ. Kjo kërkon nga të gjithë deputetët që të jenë të pranishëm dhe të votojnë, në mënyrë që të konstituojnë Kuvendin.”* (paragrafi 123 i Aktgjykimit në rastin KO119/14). Për më tepër, Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në po këtë rast ka specifikuar që: (i) *“Gjykata vëren se askund në Kushtetutë nuk parashihet që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të shkaktonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.”* (paragrafi 126 i Aktgjykimit në rastin KO119/14); (ii) *“Është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese në lidhje me Rregulloren relevante të Kuvendit dhe të bëjnë Kuvendin funksional.”* (paragrafi 127 i Aktgjykimit në rastin KO119/14); dhe (iii) *“Në konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë si të dëshirojnë, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, të votojnë “për”, “kundër” ose të abstenojnë, dhe nuk mund të lirohen nga të vepruarit kështu.”* (paragrafi 128 i Aktgjykimit në rastin KO119/14). Në vijim të kësaj, Gjykata po në rastin KO84/18 kishte ritheksuar që deputetët kanë për obligim të marrin pjesë në punimet e Kuvendit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në votim përkitazi me propozimet e paraqitura në bazë të Kushtetutës dhe të rregullave tjera të ndërlidhura. Megjithatë, Gjykata ritheksoi se *“deputetët janë të lirë të vendosin se si do të votojnë në lidhje me propozimet që janë paraqitur para tyre dhe mund të votojnë “për”, “kundër” apo “të abstenojnë” duke marrë parasysh interesin më të mirë të Shtetit në pajtim me Kushtetutën dhe me rregullat tjera.”* (shih, rastin KO84/18, cituar më lart, paragrafi 122).
142. Gjykata, në rastin KO72/20 në lidhje me detyrimin për bashkëpunimin reciprok kishte nënvizuar që: *“përcaktimi i mandatarit për Kryeministër, ngërthen detyrimin e bashkëpunimit reciprok të Presidentit dhe partisë politike fituese në këtë proces. Për më tepër, duke marrë parasysh natyrën teknike dhe formale të “konsultimit” për qëllime të caktimit të mandatarit të parë, e cila vë në lëvizje procesin e formimit të Qeverisë dhe afatet e parapara me Kushtetutë, Gjykata thekson se është e vetëkuptueshme, që ky*

“konsultim” formal, duhet të përmbillet sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe ngërthen në vetvete kërkesën për dinamikë të shpejtë ndërveprimi” Sipas Gjykatës, “në të kundërtën, të gjitha normat e lartcekura kushtetuese lidhur me afatet dhe qëllimet që ngërthejnë ato lidhur me formimin e Qeverisë, do të ishin pa asnjë efekt dhe plotësisht të panevojshme. Zgjedhja e Qeverisë do të mbetej peng i “afateve të pakufizuara” e në diskrecion të plotë të partisë politike ose koalicionit fitues apo edhe të Presidentit. E para, do të mbante peng formimin e Qeverisë, duke u thirrur në diskrecion të plotë dhe të paafatizuar për të bërë propozimin për mandatar për Kryeministër, ndërsa Presidenti po ashtu, do të thirrej në diskrecionin e plotë dhe të paafatizuar për ta dekretuar të njëjtin. Ky “diskrecion i plotë dhe i paafatizuar kohorë”, në ndërkohë ndërlidhet me zgjedhjen e Qeverisë, kompetencë kjo e një pushteti tjetër, përkatësisht Kuvendit. Një qasje dhe interpretim i tillë, do të ishte arbitrar dhe qartazi në kundërshtim me strukturën e normave kushtetuese, qëllimin e frymën e saj por edhe në kundërshtim me parimet themelore të një demokracie parlamentare. Gjykata, në këtë aspekt gjithashtu thekson se përkundër pretendimeve të parashtruesve që ndërlidhen me zgjatjen e procedurave për themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve, me theks në situatën e vitit 2014 lidhur me zgjatjen e procesit të konstituimit të Kuvendit, Gjykata në Aktgjykimin KO119/14, nuk ka trajtuar çështjen e afateve kohore që ndërlidhen me konstituimin e Kuvendit, pasi të njëjtat nuk ka qenë objekti i shqyrtimit në Gjykatë.” (shih, rastin e Gjykatës KO72/20, cituar më lart, paragrafët 569-570).

143. Kësisoj, Gjykata rithekson se Kushtetuta nuk ka përcaktuar në ndonjërin nga dispozitat e saj që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të prodhonte pasojën juridike që do të shkaktohte mbajtjen e zgjedhjeve të reja për Kuvend. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe rregullat procedurale të specifikuara më tej me Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organ përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës të jetë plotësisht funksional në ushtrimin e mandatit kushtetues. Kjo është e ndërlidhur edhe me përcaktimet e nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, përmes të cilit specifikohet që: *“Deputetët e Kuvendit ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”* Në lidhje me këtë, Gjykata nënvizon se nuk ka interes më të mirë të Republikës së Kosovës, që organi më i lart përfaqësues të jetë i konstituuar dhe të fillojë sa më parë me funksionimin e tij.
144. Prandaj, Gjykata sërish i referohet praktikës së deritanishme të saj gjyqësore, ku kishte theksuar që për konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë sipas vullnetit të tyre të lirë, me votë *“për”, “kundër”* ose *“të abstenojnë”*. (shih, rastin e Gjykatës, KO119/14, paragrafi 128).
145. Në përfundim, Gjykata rithekson se Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës. Çdo interpretim ndryshe do të relativizonte rendin kushtetues, respektivisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe do të nënkuptonte tolerim të bllokimit institucional, në kundërshtim me natyrën funksionale të një demokracie të udhëhequr nga parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit.

(ii) Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për “ndryshimin e rendit të ditës” dhe propozimin e Kryesuesit për themelimin e “Komisionit për Votim të Fshehtë”

146. Gjykata rikujton që parashtruesit në kërkesën e tyre kontestojnë ndryshimin e “rendit të ditës” së seancës për konstituimin e Kuvendit, në të cilin rast sipas tyre më 1, 3 dhe 5 maj nga Kryesuesi është propozuar themelimi i “Komisionit për Votim të Fshehtë”. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës specifikojnë që (i) “ndryshimi i rendit të ditës së seancës konstituive nga Kryesuesi” është në kundërshtim me Kushtetutën dhe se “[i] njëjti këtë e ka bërë edhe kur ka ndodhur dështimi për kalimin në votimin e fshehtë, duke devijuar dhe pamundësuar votimin e deputetëve për kryetar të Kuvendit ashtu siç përcaktohet me rendin e ditës së datës 8 prill 2025, që është rruga e vetme kushtetuese e përcaktuar me RPK dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014 për rastin KO 119/14.”
147. Në vijim të pretendimeve të lartcekura, Gjykata fillimisht i referohet nenit 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës, i cili përcakton që: “Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.” Gjykata vëren që Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Kuvendit), e cila është në fuqi, është miratuar më 28 korrik 2022.
148. Gjykata po ashtu rikujton praktikën e saj të mëhershme gjyqësore përmes të cilës ka theksuar se paragrafi 1 i nenit 64 dhe paragrafi 2 i nenit 67 të Kushtetutës përbëjnë bazën juridike për strukturimin dhe konstituimin e Kuvendit, ndërsa Rregullorja e Kuvendit e miratuar sipas autorizimeve dhe kërkesave të nenit 76 të Kushtetutës përbën mjet dhe mekanizëm procedural përmes së cilës bëhet zbatimi i dispozitave kushtetuese konkrete (shih, paragrafin 106 të Aktgjykimit në rastin KO119/14). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se neni 76 i Kushtetutës e konsideron Rregulloren e Punës së Kuvendit, të miratuar nga 2/3 e votave të deputetëve si një akt me fuqi ligjore detyruese përmes së cilës rregullohet organizimi dhe funksionimi i Kuvendit. Për më tepër, kjo dispozitë kushtetuese obligon Kuvendin të veprojë brenda procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi në përputhje me rendin kushtetutës të Republikës së Kosovës.
149. Gjykata tanimë ka dhënë vlerësimin e saj lidhur me fushëveprimin dhe kërkesat e paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës (shih, paragrafët 131-145 të këtij Aktgjykimi).
150. Në vijim, Gjykata vëren që Kreu IV [Konstituimi i Kuvendit] i Rregullores së Kuvendit specifikon procedurën që duhet të ndiqet për zhvillimin e Seancës Konstituive.
151. Sipas paragrafit 2 të nenit 8 (Përgatitja e seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit përcaktohet se: “Kryetari i legjislaturës së mëparshme, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit, e thërret mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike, që kanë fituar vende në Kuvend, për të përgatitur propozimin e rendit të ditës dhe për caktimin e vendeve të deputetëve në sallën e seancave plenare. Në rast se mbledhja nuk thirret brenda afatit pesë (5) ditorë, Kuvendi mbledhet vetë, në ditën e caktuar nga Presidenti”.
152. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se Kryetari i Kuvendit i Legjislaturës së VIII-të, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike që kanë fituar vende në Kuvend, të mbajtur më 8 prill 2025, ka bërë përgatitjen për mbajtjen e Seancës Konstituive të Legjislaturës së IX-të të Kuvendit, të thirrur nga Presidentja.
153. Sipas paragrafit 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit përcaktohet shprehimisht që: “Rendi i ditës së mbledhjes konstituive të legjislaturës përmban: 4.1 Formimin e

Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve; 4.2 Betimin e deputetëve; 4.3 Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe 4.4 Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit”.

154. Neni 7 (Seanca konstituive) e Rregullores së Kuvendit i referohet kërkesave të paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 66 të Kushtetutës, përderisa paragrafi 4 i nenit 8 (Përgatitja e seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit përcakton shprehimisht rendin e ditës të Seancës Konstituive të Kuvendit.
155. Pavarësisht që paragrafi 2 i nenit 8 të Rregullores së Kuvendit parasheh që Kryetari i legjislaturës paraprake në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike që kanë fituar vende në Kuvend merret me propozimin e rendit të ditës për seancën konstituive dhe aspekte tjera procedurale organizative, megjithatë paragrafi 4, i përcaktuar pas paragrafit 2 të nenit 8 të saj, ka definuar në mënyrë taksative dhe formale rendin e ditës për Seancën Konstituive, e cila përbën përmbajtjen kryesore dhe të vetme të seancës konstituive, dhe e cila duhet të udhëhiqet me përpikmëri nga Kryesuesi i Seancës Konstituive.
156. Konstatimi i tillë përforcohet nga fakti se Seanca Konstituive është e rregulluar në mënyrë të veçantë, me Kushtetutë dhe me Rregullore të Kuvendit, dhe si e tillë ka karakter solemn, dhe ndjek një rend dite, e që nuk i nënshtrohet procedurave të zakonshme parlamentare.
157. Nga shkresat e lëndës, Gjykata po ashtu vëren se shpërndarja e materialit të deputetët me rastin e mbajtjes së Seancës Konstituive më 15 prill 2025, është bërë duke u bazuar në kërkesat e paracaktuara për përmbajtjen e rendit të ditës sipas paragrafit 4 të nenit 8 (Përgatitja e seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit.
158. Kryesimi i Seancës Konstituive sipas nenit 9 (Kryesimi i seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit i është besuar deputetit më të vjetër në moshë, i cili këtë detyrë do ta kryejë duke u ndihmuar nga deputeti më i ri në moshë. Për më tepër, po i njëjti nen i Rregullores së Kuvendit përcakton që gjatë zhvillimit të Seancës Konstituive nuk lejohen debate (shih, paragrafin 3 të nenit 9). Kjo ndalesë ndërlidhet me karakterin solemn të Seancës Konstituive dhe poashtu kushtëzohet edhe nga natyra strikte formale e rendit të ditës të përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit.
159. Tutje, sipas paragrafit 4 të nenit 9 (Kryesimi i Seancës Konstituive) të Rregullores së Kuvendit, Kryesuesi i Seancës konstituive, pas hapjes së seancës dhe paraqitjes së rendit të ditës, kërkon nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të caktojnë nga një deputet në Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve. Këtë Komision e kryeson deputeti i subjektit politik më të madh parlamentar.
160. Sipas paragrafit 5 të nenit 9 (Kryesimi i seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, i paraqet Kuvendit raportin mbi vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit, verifikon praninë dhe kuorumin në Seancën Konstituive.
161. Më 15 prill 2025, Kryesuesi i Seancës Konstituive, procedoi me pikën e parë të rendit të ditës *“Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve”*. Në vijim të kësaj, Kryesuesi ftoi subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të caktojnë nga një deputet në përbërje të Komisionit. Sipas shkresave të lëndës, Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar që të propozojë një deputet për Kryesues të Komisionit.

162. Sipas shkresave të lëndës, të dorëzuara nga Sekretaria e Kuvendit në Gjykatë është vërtetuar që në sallë ishin 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) deputetë, dhe se kishte kuorum për t'u vazhduar me pikën e rendit të ditës. Deputetët me ngritje dore votuan për emërimin e anëtarëve të Komisionit, dhe 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) deputetë votuan për përbërjen e Komisionit. Gjykata vëren, se deputetët përmes arritjes së konsensusit të përbashkët, më 15 prill 2025, jetësuan kërkesën e pikës 4.1 të paragrafit 4 të nenit 8 (Përgatitja e Seancës Konstituive) të Rregullores së Kuvendit.
163. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se në të njëjtën ditë, respektivisht më 15 prill 2025, në vazhdimin e seancës, Raporti i Komisionit të Përkohshëm, nuk procedoi tutje për shkak se nuk mori shumicën e votave nga 113 (njëqind e trembëdhjetë) deputetët e pranishëm, dhe për pasojë nuk u vazhdua me jetësimin tutje, të pikës 4.2 të paragrafit 4 të nenit 8 (Përgatitja e Seancës Konstituive) dhe të nenit 10 (Betimi i deputetëve) të Rregullores së Kuvendit.
164. Më 17 prill 2025, vazhdoi Seanca Konstituive e filluar më 15 prill 2025. Nga shkresat e lëndës rezulton se Kryesuesi i Seancës Konstituive, i është drejtuar Presidentes së Republikës së Kosovës, duke qenë se deputetët nuk e kanë votuar Raportin e Komisionit të Përkohshëm. Gjykata vëren se edhe seanca e vazhduar konstituive e 17 prillit 2025 dështoi, dhe si rrjedhojë u përcaktua orari i radhës i mbajtjes së Seancës Konstituive më 19 prill 2025, brenda 48 orëve, në orën 12:00.
165. Gjykata vëren gjithashtu që nenet 11 (Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit) dhe 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit përcaktojnë specifikisht hapat proceduralë që duhet të ndiqen nga Kryesuesi i Seancës Konstituive në procedurën e zgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.
166. Sipas shkresave të lëndës, vërtetohet se më 19 prill 2025 është mbajtur takim konsultativ me përfaqësuesit e subjekteve politike. Në takimin konsultativ me përfaqësuesit e subjekteve politike, të njëjtit janë pajtuar që me votë unanime të votohet Raporti i Komisionit të përkohshëm dhe të vazhdohet tutje me seancën. Gjykata, në vijim vëren se më 19 prill 2025, vazhdoi seanca konstituive, ku të pranishëm ishin 120 (njëqind e njëzet) deputetë. Kryesuesi vendosi në votim formimin e Komisionit të Përkohshëm me përbërje të njëjtë, propozim që u votua nga 120 (njëqind e njëzet) deputetë dhe nga Komisioni i Përkohshëm u kërkua që të përpilojë raportin e ri. Komisioni i Përkohshëm paraqiti raportin, me të cilin konstatoi vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe i njëjti kaloi në mënyrë unanime dhe në kuadër të kësaj seance të gjithë deputetët dhanë betimin e tyre duke u bazuar në rendin e ditës, si në pikën 4.2 të paragrafit 4 të nenit 8 (Përgatitja e Seancës Konstituive) dhe me nenin 10 (Betimi i deputetëve) të Rregullores së Kuvendit. Me përfundimin e pikës së rendit të ditës lidhur me betimin e deputetëve, Kryesuesi i Seancës Konstituive, vazhdoi me udhëheqjen e pikës së rendit të ditës, zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit.
167. Duke iu rikthyer Rregullores së Kuvendit, Gjykata vëren se sipas nenit 11 (Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit) përcaktohet se:
- 1. Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstituive, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
 - 2. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga subjekti politik më i madh në Kuvend, të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit.*
 - 3. Kryesuesi i seancës konstituive konstaton rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, shpall zgjedhjen e Kryetarit dhe e fton ta zërë vendin e tij.*
168. Gjykata vëren se, më 19 prill 2025, kandidatja për Kryetare të Kuvendit, u propozua nga Grupi më i madh Parlamentar.

169. Gjykata vëren se, po ashtu, më 19 prill 2025, Kandidatja e propozuar për Kryetare të Kuvendit nga Grupi më i madh Parlamentar, përkundër se shërbimi i deputetëve konstatoi dy (2) herë radhazi se ka kuorum, e propozuara për Kryetare të Kuvendit, nuk arriti të marrë shumicën e votave për të zënë vendin e Kryetarit të Kuvendit.
170. Në vijim, më 21 prill 2025, ndërmjet pauzës prej dyzet e tetë (48) orëve, vazhdoi mbajtja e Seancës Konstituive e filluar më 15 prill 2025. Sipas shkresave të lëndës, grupi më i madh parlamentar kërkoi edhe kohë shtesë. Kryesuesi ndërpreu Seancën Konstituive dhe caktoi vazhdimin e saj më 23 prill 2025.
171. Nga shkresat e lëndës, dhe ashtu si është përshkruar si më lart, grupi më i madh parlamentar, vazhdoi me kandidaten e njëjtë të propozuar për Kryetare të Kuvendit. Emri i kandidates të njëjtë u propozua më 23, 25, 27, 29 prill 2025.
172. Propozimi i kandidates për Kryetare të Kuvendit, nuk arriti që në asnjë nga këto data të përcaktuara për vazhdimin e Seancës Konstituive të 15 prillit 2025 të marrë numrin e nevojshëm të votave për zgjedhjen për Kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
173. Gjykata sërish rithekson që “seancat” e zhvilluara për konstituimin e Kuvendit nuk konsiderohen të natyrës së një seance të zakonshme parlamentare, por këto seanca përbëjnë një seancë unike me karakter konstituiv, e cila seancë shënon fillimin e funksionimit të organit më të lartë përfaqësues të sovranit dhe të shtetit. Thënë këtë, ky karakteri unik i Seancës Konstituive kërkon edhe standard të lartë të përgjegjësisë dhe vullnetit institucional për ta realizuar atë, në frymën e bashkëpunimit kushtetues ndërmjet palëve dhe në shërbim të përmbushjes së përcaktimeve të nenit 66 të Kushtetutës.
174. Gjykata fillimisht rikujton që nga procesverbali i mbledhjes rezulton që më 1 maj 2025, në vazhdimin e Seancës Konstituive, bazuar në transkriptin e kësaj seance, Kryesuesi theksoi që: *“Deri sot kemi pasur disa tentime, por pa prodhuar rezultate në zgjedhjen e kryesisë dhe konstituimit të Kuvendit. Duke marrë parasysh aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014 për çështjen e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, përkatësisht paragrafin 124 ku thuhet: “Votimi mund të jetë i formës së hapur, i fshehtë apo cfarëdo forme tjetër.” Dhe, bazuar edhe në Rregulloren e Kuvendit, e cila në nenin 61, paragrafi 4 e parasheh edhe votimin e fshehtë. Andaj me qëllim të hapjes rrugë për zhbllokimin e procesit, konsideroj që forma e duhur që mund të hapë rrugë për konstituimin është votimi në mënyrë të fshehtë me fletëvotime fizike.”* Në vijim të këtij deklarimi, Kryesuesi ftoi partitë politike që të propozojnë nga 1 (një) anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë, lidhur me ndryshimin e mënyrës së votimit. Gjykata po ashtu vëren se në seancën e 1 majit 2025, ku u konstatua se të pranishëm ishin 100 (njëqind) deputetë, në votimin anëtarëve të propozuar për Komisionin për Votim të Fshehtë, 55 (pesëdhjetë e pesë) deputetë votuan për, 1 (një) deputet votoi kundër dhe asnjë abstenim.
175. Më pas, Seanca Konstituive vazhdoi më 3 dhe 5 maj 2025, ku Kryesuesi kërkoi përsëri nga partitë politike të propozojnë nga një anëtar për Komisionin për Votim të Fshehtë, të cilin propozim e vendosi në votim, propozim ky që (i) në seancën e 3 majit, ku të pranishëm ishin 106 (njëqind e gjashtë) deputetë, ku 54 (pesëdhjetë e katër) deputetë votuan për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim, dhe (ii) në seancën e 5 majit, ku të pranishëm ishin 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë, ku 56 (pesëdhjetë e gjashtë) deputetë votuan për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim.
176. Në lidhje me këtë, parashtresit e kërkesës theksojnë që ndryshim i rendit të ditës së Seancës Konstituive nga Kryesuesi është në kundërshtim me Kushtetutën. Në këtë kuptim, parashtresit e kërkesës në sqarimet e tyre shtesë kanë shtuar se objekt i

kërkesës është *“votimi si akt për refuzimin e votimit të fshehtë në procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht akti i votimit që refuzon këtë lloj votimi.”* Ndërsa theksojnë se objekt i kërkesës nuk është *“vendimi individual dhe arbitrar i zotit Avni Dehari për ndryshimin e agjendës së datës 8 prill 2025 për konstituimin e Kuvendit, por pasojat juridike dhe kushtetuese të këtij vendimi”*.

177. Në anën tjetër, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksuan se parashtruesit e kërkesës në mënyrë të pasaktë kanë paraqitur titullin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së *“vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë”*, për shkak se: *“jo vetëm që nuk bëhet fjalë për vendim të Kuvendit as në formë e as të mishëruar në procesverbal siç pretendojnë parashtruesit, por nuk bëhet fjalë as për kushtet e nevojshme për vendimmarrje për refuzim të votimit të Komisionit, për bëhet fjalë për mungesë kuorumi për të marrë vendim qoftë edhe për vendim për ta refuzuar votimin e Komisionit”*.
178. Gjykata thekson që çështja e mënyrës së votimit në Seancën Konstituive, përkatësisht nëse e njëjta duhet të jetë në mënyrë të hapur apo të fshehtë nuk është përcaktuar as me dispozitat kushtetuese dhe as në Kreun IV të Rregullores së Kuvendit. Gjykata vëren se Kreu i IV (Konstituimi i Kuvendit) i Rregullores së Kuvendit, në kontekstin e mbajtjes së seancës konstituive nuk përmban asnjë referencë në nenin 53 (Ndryshimi i rendit të ditës), nenin 57 (Mocionet procedurale), si dhe as në nenin 122 (Interpretimi i Rregullores së Kuvendit). Secili nga këto nene të Rregullores së Kuvendit përcaktojnë qartë dhe shprehimisht rrethanat në të cilat shtrihet fushëveprimi i tyre, palët që mund të iniciojnë ato veprime apo autorizimet e tyre, si dhe çështjet për të cilat mund të bëhen apo kohën kur mund të ngritën propozime të tilla.
179. Në vijim, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e kërkesës së tanishme, Gjykata i referohet mënyrës së votimit për zgjedhjen e organeve kushtetuese sikurse është paraparë me Kushtetutë. Gjykata vëren që përcaktimet në Kushtetutë për votimin e fshehtë janë të specifikuara në paragrafin 1 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës, përmes të cilit specifikohet që: *“Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.”*; dhe paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, përmes të cilit specifikohet që: *“Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, bëhet nga gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të Gjykatës, [...]”*.
180. Po ashtu, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, përkatësisht në Aktgjykimin e saj në rastin KO119/14 kishte theksuar që *“Në konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jene të pranishëm dhe të votojnë si të dëshirojnë, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, të votojnë “për”, “kundër” ose të abstenojnë, dhe nuk mund të lirohen nga të vepruarit kështu.”* (shih, paragrafin 128 të Aktgjykimit në rastin KO119/14).
181. Tutje, lidhur me deputetët dhe mandatin e tyre, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se sipas nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, *“deputetët janë të obliguar të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës”* (shih, rastin KO98/11, parashtrues Qeveria e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011, paragrafët 58 dhe 59). *“Se çka konsiderojnë deputetët se është në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në aspekt politik dhe në aspekt të politikave publike, është tërësisht në dorën e deputetëve të Kuvendit. Përderisa respektohet Kushtetuta, çdo zgjidhje e të zgjedhurve dhe njëkohësisht përfaqësuesve të popullit, duhet respektuar. Deputetët nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.”* (shih, rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafi 357).
182. Gjykata duke iu rikthyer rregullimit kushtetues të Republikës së Kosovës, rikujton që neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] i Kushtetutës nuk përcakton mënyrën

votimit për Kryetar dhe nënkryetarë të Kuvendit, përkatësisht nuk përcakton nëse votimi duhet të jetë i fshehtë ose i hapur. Një përcaktim i tillë, nuk është specifikuar as në Kreun IV të Rregullores së Kuvendit, dispozitat e të cilit përcaktojnë procedurën e seancës për konstituimin e Kuvendit. Në bazë të shkresave të përcjella nga Sekretaria e Kuvendit, Gjykata vëren se fillimi i procesit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, Legjislaturës së IX-të, është bërë sipas praktikave të mëparshme parlamentare.

183. Siç rezulton nga shkresat e lëndës, pas datës 29 prill 2025, në të cilën seancë për herë të fundit u propozua kandidatja nga grupi më i madh parlamentar për Kryetare të Kuvendit dhe nuk arriti të marrë shumicën e nevojshme përmes votimit të hapur, Kryesuesi i Seancës Konstituive ka vazhduar me propozim për ndryshim të mënyrës së votimit. Këtë propozim, Kryesuesi në seancën e 1 majit 2025 e arsyetoi me deblokimin e procedurës së zgjedhjes së kryetarit/es të Kuvendit. Gjykata vëren tutje se në këto tri (3) data të ndara (1, 3 dhe 5 maj 2025), Kuvendi jo vetëm që nuk arriti të zgjedhë Kryetarin/en e Kuvendit, por dështoi edhe në formimin e Komisionit të propozuar për udhëheqjen e procesit të votimit të fshehtë, dhe përkundër faktit që u konstatua se në këto tri “seanca” të pranishëm ishin: 110 (njëqind e dhjetë) deputetë në seancën e 1 majit, me ç’ rast 55 (pesëdhjetë e pesë) deputetë votuan për, 1 (një) deputet kundër dhe asnjë abstenim; 106 (njëqind e gjashtë) deputetë, në seancën e 3 majit, ku 54 (pesëdhjetë e katër) deputetë votuan për, një (1) kundër dhe asnjë abstenim; dhe 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë të pranishëm në seancën e 5 majit, ku 56 (pesëdhjetë e gjashtë) deputetë votuan për, një (1) kundër dhe asnjë abstenim. Në vijim të kësaj, Gjykata sqaron se data 5 maj 2025 e mbajtjes së Seancës Konstituive, është data e fundit për të cilën Gjykata disponon me shkresat e lëndës, duke qenë se kërkesa e parashtruar nga parashtruesit e kërkesës, është regjistruar pranë Gjykatës më 12 maj 2025.
184. Gjykata rikujton sërish nenin 67, paragrafin 2 të Kushtetutës që përcakton se: *“Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.”* Në vijim të kësaj, Gjykata tashmë ka theksuar se e drejta për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit nga grupi më i madh parlamentar është kushtëzuar me arritjen e shumicës së votave të të gjithë deputetëve që kandidati i propozuar duhet të marrë për tu zgjedhur Kryetar Kuvendi.
185. Rrjedhimisht, ky kriter kushtetues që ka kushtëzuar të drejtën e propozimit me detyrimin për të siguruar numrin e nevojshëm të votave për Kryetar/e të Kuvendit, kërkon bashkëpunim në mirëbesim nga deputetët e zgjedhur për të gjetur kompromisin apo konsensusin e domosdoshëm për të gjitha çështjet që dalin apo mund të dalin duke përfshirë zgjedhjen e kandidatit/es për Kryetar/e të Kuvendit, apo mënyrën e votimit, gjatë formimit të organeve kushtetuese pas zgjedhjeve të lira, por gjithmonë brenda kërkesave dhe kufijve të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Rregulloren e Kuvendit.
186. Marrë për bazë elaborimin si më sipër, Gjykata ka konstatuar që: (i) Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, e cila pas dhënies së betimit të deputetëve duhet të finalizohet me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës; (ii) është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe rregullat procedurale të specifikuarat më tej me Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organ përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës të jetë plotësisht funksional në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues; (iii) në Seancën Konstituive të gjithë deputetët e zgjedhur duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë sipas vullnetit të tyre të lirë, duke votuar “për”,

“kundër” ose “të abstenojnë”. Në vijim të këtyre konstatimeve, Gjykata ka specifikuar se konstituimi i Kuvendit duhet të realizohet sa më shpejt dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të Gjykatës.

187. Rrjedhimisht, Gjykata marrë për bazë vlerësimin dhe konstatimet si më sipër konsideron që zhvillimi dhe përfundimi i Seancës Konstituive duhet të udhëhiqet në pajtim me përcaktimet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, Kreun IV (Konstituimi i Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përfundim

188. Gjykata rithekson që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlidhet me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo bllokojë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre. Kësisoj, të gjitha veprimet që ndërmerren nga deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar.
189. Gjykata konstatoi që Seanca Konstituive e filluar më 15 prill 2025 si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit nuk ka përfunduar. Si rrjedhojë, Gjykata vlerësoi që Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, e cila pas dhënies së betimit të deputetëve duhet të finalizohet me zgjedhjen e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës.
190. Në këtë kuptim, Gjykata vlerësimin e saj e mbështeti në atë se: (i) mandati i deputetit dhe mandati i Kuvendit janë të ndërlidhura, pasi që deputetët përfaqësojnë sovranin, por ky përfaqësim nuk mund të jetësohet në aspekt institucional pa konstituimin e Kuvendit; (ii) zgjedhja e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit është parakusht që Kuvendi të fillojë të funksionojë dhe kjo kërkon nga të gjithë deputetët që të jenë të pranishëm dhe të votojnë për konstituimin e Kuvendit në mënyrë që ky i fundit të fillojë sa më shpejtë të funksionojë si organ ligjvënës, vendimmarrës dhe mbikëqyrës; (iii) e drejta për të propozuar Kryetarin/en e Kuvendit, e rezervuar për grupin më të madh parlamentar, është vendosur përmes Aktgjykimit në rastin KO119/14; (iv) propozimi i kandidatit për Kryetar/e të Kuvendit është i ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me arritjen e shumicës së votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, dhe si e tillë kjo e drejtë për propozimin e kandidatit për Kryetar/e të Kuvendit përbën njëkohësisht edhe detyrim për grupin më të madh parlamentar për bashkëpunim në mirëbesim dhe konsultim konstruktiv me grupet e tjera parlamentare për të gjetur konsensusin apo kompromisin e nevojshëm. Kjo e drejtë në asnjë mënyrë nuk mund të rezultojë në bllokimin e konstituimit të Kuvendit dhe se detyrimi për bashkëpunim konstruktiv në mirëbesim që buron nga vetë neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] i Kushtetutës njëkohësisht ndërlidhet ngushtë edhe me detyrimin e përcaktuar në nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, sipas të cilit deputetët e Kuvendit ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit; (v) një detyrim i tillë vlen edhe për grupet e tjera parlamentare të cilët në frymën e bashkëpunimit dhe konsultimeve konstruktive propozojnë kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit, të cilët bazuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës po ashtu zgjedhen

me shumicën e votave të të gjithë deputetëve; dhe (vi) është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin/en dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës, rregullat e specifikuar në Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

191. Rrjedhimisht, deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], në ndërlidhje me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] dhe nenet 70 [Mandati i Deputetëve] dhe 74 [Ushtrim i Funkcionit] të Kushtetutës, në pajtim me Kreun IV (Konstituimi i Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit dhe konstatimet në këtë Aktgjykim duhet që sa më shpejtë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi të përmbushin detyrimin kushtetues për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

192. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme, duke pezulluar për pasojë *“dëmtimin e pariparueshëm të imazhit të Kuvendit të Kosovës në rast të vazhdimit të seancave konstituive me rend të ditës të përcaktuar në mënyrë jokushtetuese dhe dëmtimin e imazhit të Shtetit të Kosovës në vend dhe në botën e jashtme në rast të vazhdimit të seancave jokushtetuese si më sipër”*.
193. Në këtë kontekst, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata thekson se është i panevojshëm shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për masë të përkohshme (shih, rastin e Gjykatës KI207/19, parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 237; dhe shih gjithashtu rastin KO93/21, cituar më lart, paragrafi 368).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 26 qershor 2025:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, që:
 1. Seanca e konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 15 prill 2025, nuk ka përfunduar dhe si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është zhvilluar në pajtim me përcaktimet dhe kërkesat e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
 2. Deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] në ndërlidhje me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kreun IV të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Aktgjykim duhet që sa më shpejt dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë të përfundojnë Seancën Konstituive të Kuvendit duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.
- III. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masën e përkohshme;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- V. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- VI. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Remzije Istrefi - Peci

Nexhmi Rexhepi